

## **Departamenti Operacioneve të Zgjedhjeve**

**Shërbimet e Partive Politike  
Njësia e Revizionit**

### **RAPORTI MBI SHPENZIMETE FUSHATËS ZGJEDHORE ZGJEDHJET KOMUNALE 2002**

**Dhjetor 2002**

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE.....</b>	<b>3</b>
<b>2. VLERËSIMET E PËRGJITHSHME .....</b>	<b>4</b>
<b>3. BURIMET E TË DHËNAVE.....</b>	<b>6</b>
<b>4. ANALIZË E PËRGJITHSHME E RAPORTEVE TË DORËZUARA .....</b>	<b>7</b>
<b>5. ANALIZA SIPAS SUBJEKTEVE.....</b>	<b>13</b>
5.1 LDK.....	14
5.2 PDK.....	17
5.3 AAK .....	20
5.4 KP.....	24
5.5 DSS.....	26
5.6 KDTP.....	26
5.7 VATAN .....	27
5.8 PREK .....	29
5.9 IRDK .....	32
5.10 SNV .....	33
5.11 LKÇK.....	34
5.12 RIZA LLUKA (KANDIDAT I PAVARUR) .....	36
5.13 SUBJEKTET ME KANDIDAT TË ZGJEDHUR, POR JO TË ANALIZUARA NE DETAILE <sup>1</sup> .....	38
5.14 SUBJEKTET PA KANDIDAT TË ZGJEDHUR, POR JO TË ANALIZUARA NE DETAILE <sup>1</sup> .....	39
<b>6. SHTOJCA A SHPREHJET DHE DEFINICIONET .....</b>	<b>40</b>
<b>7. SHTOJCA B PARAQITJA E RAPORTIT TË DYTË FINANCIAR .....</b>	<b>40</b>
<b>8. SHTOJVA C FLETË BALANSI DHE LLOGARIJA E FITMIT DHE HUMBJES.....</b>	<b>40</b>
<b>9. SHTOJCA D REGJISTRI I DONACIONEVE MONATARE DHE KONTRIBUTEVE NË MALL DHE SHËRBIMEVE PËR PARAQITJEN E 1-RË DHE TË 2-TË RAPORTIT FINANCIAR .....</b>	<b>40</b>

## 1. Hyrje

Në kuadër të kërkesave nga të gjitha subjektet e vërtetuara që kanë marrë pjesë në zgjedhjet komunale të mbajtura para një kohe është dashur të dorëzohet raporti i publikimit financiar në dy raste: në fillim të periudhës së fushatës dhe në fund të periudhës së fushatës.

Qëllimi i raporteve të tilla është që të sigurohet që subjektet politike të Kosovës të angazhohen dhe të kuptojnë se transparenca është vlera thelbësore në shoqëritë demokratike. Ky angazhim nuk është i obligueshëm vetëm për zyrtarët e zgjedhur të partisë (publikimi financiar i kandidatit) por bën kompromis edhe me mekanizmat e brendshëm të subjekteve politike. Në periudhën e zgjedhjeve në këtë vit është shumë e rëndësishme se si formohen dhe si shpenzohen fondet nga këto subjekte. Së bashku me këto raporte shpenzimet e fushatës së zgjedhjeve, të gjitha partitë politike të regjistruara duhet t'i dorëzojnë raportet financiare vjetore sipas kornizës aktuale të partive politike të regjistruara në Kosovë (Rregulla e UNMIK-ut 2002/8 *mbi regjistrimin dhe veprimin e partive politike në Kosovë*). Megjithatë, vetëm 28 nga 68 subjekte politike të vërtetuara janë parti politike të regjistruara. Ky fakt e shton rëndësinë e dy raporteve të publikimit financiar të fushatës, meqë ato janë mjeti i vetëm që jep informacion nga subjektet politike përveç partive politike: iniciativat qytetare, koalicionet dhe kandidatët e pavarur.

### 1.1 Rregulla e Zgjedhjeve 5/2002

Rregulla e Zgjedhjeve 5/2002 mbi publikimin financiar të fushatës dhe kufinj të shpenzimeve kërkon nga subjektet politike të vërtetuara që të garojnë në Zgjedhjet e kuvendeve komunale 2002 t'i publikojnë të gjitha të hyrat e fushatës dhe shpenzimet së bashku me aktivin dhe pasivin që i ka subjekti në të dyja rastet. Deklara e parë financiare përfshin periudhën nga 3 qershori deri më 9 shtator, kurse deklarata financiare e dytë dhe përfunimtare e përfshin periudhën e fushatës nga 10 shtatori deri më 26 tetor. Ky raport i revizorëve të OSBE-së merr parasysh vetëm deklaratën e dytë financiare të subjekteve politike. Sipas nenit 5 të kësaj rregulle me të cilën themelohet Zyra e Revizionit të Financave Politike të OSBE-së dhe i jep kësaj Zyreje kompetenca "për të inspektuar shënimet financiare të çdo subjekti politik duke i përfshirë të gjitha llogaritë, dëftesat, llogaritë e pagueshme dhe deklaratat financiare", revizorët e OSBE-së i kanë trajnuar dhe janë takuar shpeshherë me personat e financave për kontakte gjatë periudhës së raportimit si dhe pas saj. Revizorët e OSBE-së kanë bërë hetime të plota të raporteve të dorëzuara nga subjektet politike për të konstatuar pajtimin me rregullat siç cekën në Rregullën e Zgjedhjeve.

### 1.2 Programi i revizionit

Sipas standardeve ndërkombëtare të revizionit, revizioni që duhet të bëhet për zgjedhjet komunale do të jetë më shumë një angazhim për shqyrtim ose revizion i pjesërishtë, meqë ai përfshin vetëm një pjesë të shkurtër të vitit. Revizioni i plotë dhe komplet do të jepte pasqyrë më të qartë të gjendjes financiare të subjekteve politike, dhe në këtë mënyrë do të përgjigjej në pyetjet të cilat nuk janë sqaruar plotësisht në këtë revizion. Revizioni i tillë do të bëhet për herë të parë në vitin 2003, kur do të kërkohet nga të gjitha partitë politike të regjistruara të dorëzojnë raportet financiare vjetore në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 8/2002.

### 1.3 Vlerësimi i rrezikut

Edhe pse është viti i dytë që revizorët ndërkombëtarë të OSBE-së kanë bërë këtë revizion, shumë nga subjektet politike dhe personat e tyre të financave për kontakte përjetuan për herë të parë t'i nënshtrohen revizionit. Kjo shpjegon pse të dhënat e revizionit dhe dokumentacioni janë të cilësisë më të ulët seç kërkohet, dhe mund të ketë rrezik të padëshiruar financiar, rrezik të kontrollit dhe rrezik të hetimit. Për këtë arsye revizorët janë detyruar të përdorin burime të tjera të informimit, dëshmi të revizionit për të dhënë raporte të sakta dhe të besueshme.

### 1.4 Rëndësia themelore

Rëndësia themelore i referohet cilësisë së informatës që përfshihet në shënimet financiare me të cilat punon Njësia e Revizionit. Në rastet kur informata e tillë mungon ose konsiderohet të jetë e pasaktë, revizorët kanë përfshirë shifra të përafërta për t'iu afruar saktësisë ose për ta përmirësuar mungesën ose gabimin. Shifrat e përafërta janë përfshirë në analizat e rasteve në nenin 4 dhe në shtojcën C.

#### a) Rëndësia themelore e përgjithshme

Ky revizion përmban një spektër nga subjektet e mëdha deri te ato të voglat. Edhe kur kemi të bëjme me rast të tillë, duhet të merret parasysh rëndësia themelore në mënyrë që të vlerësohet shkalla e gabimeve të tolerueshme.

#### b) Rëndësia themelore e pjesërishtme

Është detyrë e revizorëve t'i përcaktojnë shpenzimet dhe të hyrat e përgjithshme për çdo subjekt individual. Nuk duhet të konsiderohet gabim i patolerueshëm edhe nëse gabimi është mbi kufi ose nëse vetë njësia ka rëndësi më të vogël për rezultatin e përgjithshëm.

### 1.5 Rekomandime

- Njësia e Revizionit rekomandon që revizioni duhet të përqendrohet në ato subjekte që kanë zënë vende nëpër komuna të ndryshme. Veç kësaj, të gjitha partitë politike të regjistruara të Kosovës, pa marrë parasysh nëse kanë zënë vende apo jo, do të shqyrtohen nga revizorët.
- Njësia e Revizionit rekomandon që margjina e tolerueshme e gabimeve të caktohet deri në 10%, por jo më pak se 10,000 €.

Siç kërkohet me këtë Rregull të Zgjedhjeve, të gjitha subjektet politike kanë marrë programin për revizion para afatit të fundit të dorëzimit të dytë të deklaratës financiare.

## 2. Vlerësimet e përgjithshme

Si dhe do të shihni në këtë raport, përqëndrimi parësor i Njesisë së Revizionit ishte që t'a përcaktoj sa më saktësisht që është e mundur vlerën që secilit subjekt politik ka shpenzuar për fushatë. Arsyet për këtë janë të dyfishta: (1) çdo subjekt politik ishte i kufizuar me kufizimin e shpenzimeve të vendosur nga KQZ-ja nga 0,5 € për votues të regjistruar; (2) një vlerësim i saktë i shpenzimeve jep një përshkrim të saktë për nivelin e të hyrave të gjeneruara nga partia për ta financuar fushatën. Edhe pse zbatimi i kufizimit të shpenzimeve është një pjesë e rëndësishme e

procesit të publikimit të financave, qëllimi themelor i publikimit të financave është në detyrimin e partive t'i publikojnë burimin e të hyrave të tyre. Meqenëse, partitë politike në Kosovë varen vetëm nga donacionet dhe tarifat e përkrahësve për të ndërmarr operacionet e tyre të përditshme dhe të mbajnë fushatën zgjedhore, afësia e partisë politike që të tërheq donatorët e mëdhenj është shpeshherë qelës i suksesit të tyre. Kështu që, veçanërisht është e rëndësishme për votuesit të dinë se kush i financon partitë politike për të cilat ata votojnë, sikurse që ekziston mundësia që donatorët presin nga partitë politike që i financojnë që interesat e tyre të merren parasysh me zgjedhjen e përfaqësuesve të partisë.

Rezultatet dhe vëzhgimet e përgjithme

Rezultatet detale të revizimit do të diskutohen përmes këtij dokumenti, po disa rezultate të veçanta meritojnë të jenë të theksuara.

- 1) Njësia e Revizionit nuk ka gjetur dëshmi se ndonjëra nga subjektet politike ka tejkaluar kufizimin e shpenzimeve të fushatës. Kjo është e kundërta me vitin 2001 kur dëshmit e tyre kanë treguar se LDK dhe PDK kanë tejkaluar kufizimin e shpenzimeve.
- 2) Si dhe do të tregohet përmes këtij raporti, shumë subjekte politike nuk janë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat për publikimin e financave, edhe përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të revizorëve t'ju asistojnë dhe inkurojnë pajtueshmërinë. Në përputhje me procedurën administrative që qeveris punën e Njesisë së Revizionit, revizorët kanë ndarë të gjeturat (rezultatet) e tyre me NKZPA dhe kanë ngritur ankesat kundër 13 subjekteve politike të cilët kanë dështuar t'i takojnë kërkesat për publikim. Revizorët konsiderojnë si shkelje më seriose të jetë regjistrimi i raporteve çorientuese si dhe dështimi të publikojnë burimet e të hyrave. Është përgjegjësi e NKZPA pastaj që të vlerësoj thyerjen dhe të caktoj saksionet e duhura.
- 3) Njësia e Revizorëve vazhdon të jetë e brengosur lidhur me faktin se poçasërisht partitë më të mëdha vazhdojnë të rezistojnë të zbulojnë (publikojnë) reporte të sakta financiare. Kjo është në veçanëri shqetësuese në konsiderim se përfaqësuesit e zgjedhur të këtyre partive janë gjithnjë e më shumë përgjegjës në të dy nivelet atë komunale dhe në nivel të Kosovës për rekrutimin e taksave, caktimin e kontratave, buxjetimin dhe shpenzimin. Nëse partitë nuk janë të gatshme që të jenë transparente ndaj votuesve të Kosovës, sjell një shembull të keq për përfaqësuesit e këtyre partive të cilët tani janë në pozita të qeverisjes. Si shembull i mëtejshëm i keq është ai i vendosur nga partitë politike në fushën e përgjegjësisë fiskale, revizorët kanë vërejtur se asnjëra nga partitë politike që punësojnë kanë paguar punëtorët, me përjashtim të PLK-së, aktualisht mbajnë tatimet nga të ardhurat të kërkuara nga autoritete tatimore, siç është kërkuar në rregulloren e UNMIK-ut 2002/4.

## TË ARRITURAT NË VITIN 2002

Mendimi i njesisë së revizionit është që procesi i publikimit të financave në Zgjedhjet Komunale 2002 ka treguar përmisime të dukshme në krahasim me rezultatet e procesit të publikimit të financave në vitin 2001.

- 1) në vitin 2002 subjektet politike ishin të obliguara të publikojnë si shtesë të hyrave dhe shpenzimeve gjatë fushatës zgjedhore, të hyrat dhe shpenzimet gjatë tre muajve para fushatës zgjedhore.
- 2) Një transparencë më e madhe është aritur duke iu dhënë mediave dhe organizatave të vëzhguesve qasje më të madhe procesit të publikimit të financave. Pjesëtarët e publikut të gjerë tani kanë qasje në deklaratat personale financiare të përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, në listen e donatorëve të subjekteve politike të cilat kanë marrur pjesë në zgjedhje dhe shënimet e të hyrave dhe shpenzimeve të deklaruara nga subjektet politike.
- 3) Njësia e revizionit ka qënë shumë e asistuar nga koperimi i shtuar me UNMIK-un (veçanërisht me Regjistrin e automjeteve, Zyrën Kadastrale, Autoritetet Tatimore, Zyrën Statistikore) dhe

OJQ-në KMDLNJ-në. Duke siguruar që përgjegjësia financiare e partive politike gjithnjë e më shumë do të varet nga ko-operimi ndërmjet administratorve zgjedhor dhe OJQ-ve vëzhguese siç është KMDLNJ-a, në mënyrë që të jëtë efektive.

- 4) Disa nga subjektet politike, veçanërisht ato më të vogla kanë treguar një gatshmëri të sinqertë për të qenë më transparent lidhur më çështjet financiare ndaj publikut. Në përgjithësi janë bërë disa përmisime në kualitetin e raporteve nga shumë parti politike, edhe pse siç edhe ky raport do të demonstroj është ende një rrugë e gjatë para se partitë politike të Kosovës të jenë me të vertetë transparente ndaj votuesve lidhur me statusin e tyre financiar.

#### REKOMANDIMET PËR PËRMISIM

Është e qartë se shumë përmisime janë ende të nevojshme, në anën e partive politike, njësisë së revizionit dhe kornizës regulluese, në mënyrë që të sigurohet transparenca më e madhe e mundëshme në sjelljet financiare të partive politike. Disa nga këto rekomandime janë të radhitura si vijon:

- 1) Njësia e Revizorëve ka qenë në përgjithësi e hendikepuar në kompetencat e tyre që të revizojnë tërësisht përshkak të mungesës së raportit financiar vjetor të partive politike. Sidoqoftë, kjo do të ndryshoj në vitin 2003 kur të gjitha partitë politike të regjistruara në Kosovë do të jenë të obliguara, në pajtueshmëri më Regullorën e UNMIK-ut 8/2002, të regjistrojnë deklaratat financiare vjetore në zyrën për regjistrimin e partive politike.
- 2) Edhe pse Nën Komisioni Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa (NKZPA) ka sanksionuar shumë nga subjektet politike financiarisht si dhe me largimin e kandidatëve për dështim për të qenë në pajtueshmëri me kërkesat e publikimit të financave, është e qartë se efektiviteti i sanksioneve në inkuarimin për pajtueshmëri ishte e përzier. Xhobot të propozusra nga NKZPA- ja ishte shumë e mirë në motivimin e partive të vogla të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e publikimit, por për partitë më të mëdha, e veçanërisht LDK, PDK dhe AAK, është e qartë se niveli i sanksioneve të bëra ( qofshin ato financiare apo të tjera) nuk kanë qenë të mjaftueshme t'i detyroj këto parti të pajtohen me kërkesa e publikimit.
- 3) Veçanërisht për subjektet e vogla politike politike, kualiteti i raportimit në anën e këtyre subjekteve politike ishte e penguar nga aftësitë adekuate të llogarimbajtjes. Njësia e Revizionit tenton ti intensifikoj tajnimet për personeli administrativ të subjekteve politike, që të siguroj që personeli i subjekteve politike kanë aftësinë e nevojshme që të dorëzojnë raportet më sakta të mundëshme.
- 4) Është mendimi i njësisë së revizionit se edhe pse sanksionet e NKZPA-së kanë vendin e tyre në inkuarimin e subjekteve politike të jenë në pajtueshmëri me rregullat, në fund gjykimi i opinionit publik është më e rëndësishme për subjektet politike. Prandaj, edhe pse autoritetet zgjedhore mund të një revizor dhe të hulumtoj të hyrat dhe shpenzimet e partive politike, media dhe organizatat e shoqërisë civile duhet ti përdorin këto informata ti shtyjnë partitë politike të jenë më transparente në sjelljet e tyre financiare.

### 3. Burimet e të dhënave

Në kryerjen e revizionit, Njësia e Revizionit së pari është mbështetur në raportet e publikimit të financave të dorëzuara nga subjektet politike. Krahasimi subjekt për subjekt i raporteve të marra ka siguruar një kontrollim të vlefshëm përkitazi me çështjen nëse të dhënat e ofruara nga çdo subjekt i vetëm janë të arsyeshme dhe të besueshme, kur të krahasohen me shpenzimet e ngjashme të subjekteve të tjera. Revizorët kanë bërë hetime duke i mbledhur çmimet e mallrave dhe të shërbimeve të ndryshme nga bizneset dhe furnizuesit në Kosovë. Për më tepër, revizorët kanë shfrytëzuar burime të shumta të të dhënave në kuadër të OSBE-së. Pa këto burime, ky synim do të realizohej me më shumë vështirësi.

Zyrtarët e UNMIK-ut nga Agjencioni i Kadastrës së Kosovës; Departamenti i Shërbimeve të Menaxhimit të Inxhinieringut dhe Ndërtesave; Enti Statistikor i Kosovës; regjistrimet e automobilave, dhe autoritetet e taksave janë konsultuar lidhur me saktësinë e të dhënave të siguruara nga subjektet përkitazi me çështjet për të cilat UNMIK-u mban përgjegjësinë e rregullativës. Për shkak të rolit të vetëm që luan UNMIK-u në Kosovë, të dhënat e marra prej burimeve të tij janë shumë të rëndësishme për punën e revizorëve. Burim tjerët i të dhënave mbi tubimet politike gjatë fushatës së zgjedhjeve ka qenë Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ).

#### 4. Analizë e përgjithshme e raporteve të dorëzuara

Subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e kuvendeve komunale sipas Rregullës së Zgjedhjeve 5/2002 është dashur t'i dorëzojnë formularët e përgatitur për selitë e tyre dhe për të gjitha degët, përfshirë edhe ato degë për të cilat ato subjekte janë vërtetuar për të marrë pjesë në zgjedhje.

Neni 2.1 i Procedurës Administrative 2002/05 cakton afatin e fundit për dorëzimin e dytë të Formularit 308 të DOZ-it, më 11 nëntor 2002, në orën 17.00. Shumica e subjekteve politike të vërtetuara i kanë dorëzuar formularët e tyre me kohë. Deri në afatin e fundit, 52 prej 68 subjekteve që kanë marrë pjesë në zgjedhje i kanë dorëzuar të gjitha ose disa prej deklaratave mbi publikimin e financave të tyre. Deri në përfundim të orarit më 2 dhjetor, 10 subjekte nuk kanë dorëzuar asnjë deklaratë. Shtojca B përshkruan se cilat subjekte i kanë dorëzuar formularët me kohë të cilat nuk i kanë dorëzuar dhe për cilat degë të komunave.

Dorëzimet e vona ose të mangëta të raporteve e kanë detyruar Shërbimin e Partive Politike (SHPP) të parashtrorë ankesa pranë NKZPA-së kundër atyre subjekteve që nuk i janë përmbajtur Rregullës së Zgjedhjeve të lartpërmendur. Njësia e Revizionit i konsideron të dhënat e publikuara nga subjektet politike si paraqitje *bona fide*. Ky fakt nuk nënkupton se në rastet kur të dhënat e publikuara ka gjasa të jenë të pasakta dhe të paplota nuk do të zhvillohen hetime të mëtejme. Në këtë kuptim, një referencë e mirë për vlerësim është raporti mbi publikimin e financave të fushatës së zgjedhjeve, i paraqitur nga subjektet politike të vërtetuara për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura në nëntor të vitit 2001. Në disa raste, kontrollimi i hollësishëm i shifrave të deklaruara nga subjektet ka dhënë rezultate interesante. Deri tani janë parashtruar ankesa kundër subjekteve vijuese (Shënim: të gjitha subjektet politike të paraqitura në këtë raport do të paraqiten me akronimin e tyre. Udhëzimin rerefues për emrat e plotë të subjekteve mund ta gjeni në shtojcën B.):

- Për shkak të mosdorëzimit: SPO, PD, PNDSh, GISK, GIK, LZKUS dhe Opstanak.
- Për shkak të dorëzimit me vonë: BK, BSDAK, Veselin Radović, PRSH, KOS dhe GIZ.
- Për shkak të dorëzimit jo të plotë: AAK, LDK, PDK, BDIKHB, DSS, GIG, IRDK, KP, IQFK, IQV, LPK, OSPA, PDAK, PKM, PREBK, PReK, PSHDK, Riza Lluka, SDP dhe UNIKOMB.

Në përputhje me Procedurën Administrative të DOZ-it 2002/05, neni 7.6, subjektet e inspektuara janë paraqitur me rezultatet e revizionit dhe atyre u janë dhënë 48 orë për të ndryshuar, arsyetuar ose për të hedhur poshtë parregullësitë. Deri në afatin e fundit për përgjigje të subjekteve, më 2 dhjetor, tetë subjekte të vogla kanë vepruar kështu.

Në përgjithësi, 58 subjektet politike që i kanë dorëzuar raportet kanë pohuar se shpenzimet e tërësishme të tyre gjatë fushatës kanë arritur në 883,300 €. Shpenzimet janë mbuluar nga të hyrat e publikuara prej 626,900 € për të 58 subjektet. Në fillim të periudhës së fushatës, këto subjekte kanë paraqitur borxhe prej gjithsej 112,000 €. Në përfundim të periudhës së fushatës, borxhet e

tyre të publikuara janë ngritur në 256,400 €. Detajet e mëtejme në parimin 'subjekt për subjekt' do të shqyrtohen në Kapitullin 4.

Në përgjithësi, procesi i revizionit financiar ka zbuluar se shumica e subjekteve politike në raportet e tyre i kanë zvogëluar shpenzimet e fushatës, disa prej tyre gjer në shkallë serioze. Njësia e Revizionit financiar mendon se parregullsitë shfaqen edhe në paraqitjen e të hyrave më të ulëta, qofshin ato donacione me të holla apo kontribute me mall.

Vijon vlerësimi i përgjithshëm i konstatimeve të zakonshme në raportet e subjekteve të ndryshme.

#### 4.1 Kontributet me mall

Për këtë revizion financiar, kontributet me mall janë definuar si mallra dhe shërbime të pranuar pa asnjë kompensim financiar. Pra, kontributi me mall bëhet p.sh: kur subjekti politik merr hapësirën për zyre pa pagesë; kur i mban tubimet pa paguar qira për ndërtesat ose shërbimet e këngëtarëve dhe të zbatimësve; ose kur pranon shërbime pune nga aktivistët në bazë vullnetare (përveç formës me punë vullnetare të pakualifikuar të ofruar nga individë privatë). Kontribut me mall ose me shërbime poashtu konsiderohet kur dikush jep pa para automjetin, ose lëndën djegëse dhe shoferin. Për më tepër, kontributet me mall nuk kufizohen me shembujt e dhënë më poshtë.

#### 4.2 Kontributet me para

Rregulla e Zgjedhjeve 5/2002 detyron subjektet politike që të publikojnë identitetin e të gjithë personave që u japin subjekteve donacione, kontribute, ose pagesa me mall ose me shërbime. Njësia e Revizionit ka mbledhur emrat e donatorëve të subjekteve politike në mënyrë që të përpilojë një listë që tregon shumën e donacionit dhe identitetin e donatorit. Lista do të jepet për shqyrtim publik në përputhshmëri me Rregullën e Zgjedhjeve të lartpërmendur.

Gjersa shumica e subjekteve politike kanë qenë të gatshme të paraqesin emrat e donatorëve, duhet të theksohet se vetëm disa subjekte kanë publikuar plotësisht të hyrat e tyre. Revizorët kanë zbuluar shembuj seriozë të paraqitjes më të ulët të shpenzimeve. Nga kjo rrjedh logjikisht se edhe të hyrat e përdorura për mbulimin e shpenzimeve të fushatës ngjan të jenë paraqitur më të ulëta sesa niveli ekuivalent. Në lidhje me kontributet me mall, revizorët mendojnë se shumica e subjekteve politike nuk respektojnë kërkesën e publikimit si të hyra, mallra dhe shërbime që i janë dhuruar subjektit.

#### 4.3 Spotet televizive dhe të radios

Të gjitha subjektet politike të vërtetuara kanë paraqitur shpenzime të përgjithshme prej 80,700 € për realizimin e TV/radio spoteve. Rregulla e Zgjedhjeve 10/2002, neni 3, u lejon subjekteve politike të vërtetuara qasje të lirë dhe të paanshme në mediat transmetuese. Tetëmbëdhjetë subjekte të vërtetuara kanë emituar TV spote dhe 12 prej tyre kanë realizuar radio spote. Kohëzgjatja e emitimit që i është dhënë secilit subjekt është bazuar pjesërisht në rezultatet e subjektit në Zgjedhjet për Kuvend të vitit 2001 dhe në numrin e subjekteve që kanë marrë pjesë në zgjedhje për seclën komunë.

#### 4.4 Tubimet

Për shkak të numrit të kufizuar të revizorëve, është vendosur që për monitorimin e tubimeve të kërkohet ndihmë nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe vëzhguesit e organizatave më të mëdhaja vendore për vëzhgim të akredituara për procesin e zgjedhjeve.



Në mënyrë që të marrë informata standarde nga vëzhguesit lokalë, Njësia e Revizionit ka përpiluar një formular specifik – *Formularin e vëzhgimit të tubimeve*. Në këtë formular, vëzhguesit janë lutur t'u përgjigjen pyetjeve specifike: vendi i tubimit, pajisjet e zërimit dhe bina e përdorur, programi artistik, automjetet e përdorura nga subjekti, numri i truporëve dhe i personelit të sigurimit, numri i personave që kanë marrë pjesë në tubim, etj. Të gjitha këto të dhëna u kanë mundësuar revizorëve të vlerësojnë shpenzimet e tubimit të vëzhguar. Për revizorët ky ka qenë burimi kryesor i informatave për vlerësimin e shpenzimeve të tubimit gjatë fushatës së zgjedhjeve.

Pos kësaj, për të bërë vlerësime janë përdorur edhe shënimet e Policisë së UNMIK-ut. Pasi që shënimet e Policisë së UNMIK-ut përfshijnë të dhënat mbi vendin e tubimit dhe numrin e njerëzve që kanë marrë pjesë, ato i kanë ofruar Njesisë së Revizionit informata të besueshme për verifikimin e të dhënave të marra nga organizatat vendore të vëzhgimit.

### Tubimet që KMDLNJ i ka vëzhguar dhe ia ka paraqitur Njesisë së Revizionit

	<i>Numri i përgjithshëm i tubimeve</i>	<i>Numri i tubimeve të vëzhguara</i>	<i>Përqindja e tubimeve të vëzhguara</i>
AAK-ja	114	73	64%
BK-ja	5	1	20%
DPP-ja	1	1	100%
DSS-ja	2	1	50%
IRDK-ja	4	1	25%
KDTP-ja	4	3	75%
KOS-ja	2	2	100%
LDK-ja	277	83	30%
LKCK-ja	9	3	33%
LPK-ja	8	5	63%
PD-ja	8	2	25%
PDASHK-ja	4	3	75%
PDK-ja	298	111	37%
PLK-ja	14	7	50%
PREK-ja	8	4	50%
PSHDK-ja	8	8	100%
UDGJ-ja	3	1	33%

Përkundër aktivitetit intensiv të vëzhgimit të zhvilluar nga organizatat vendore të vëzhgimit, Njësia e Revizionit nuk ka mundur të mbledhë të dhëna për të gjitha tubimet e mbajtura në Kosovë gjatë periudhës së fushatës. Prandaj, për tubimet që nuk janë vëzhguar revizorët kanë përdorur mesatare të përafërta. Sipas informateve të marra nga burime të ndryshme, mesatarja e përafërt e mjeteve të nevojshme për ta mbajtur një tubim politik, kur këto të dhëna nuk janë publikuar nga subjektet politike, ka qenë si vijon:

	Artikulli	Shpenzimet (në €)
1	Sistemi i zërimit (përfshirë montimin, fuqinë punëtore, mikrofonat, kabllot dhe rrymën)	500-3000
2	Këngëtari(ja)	400-2000
3	Grupet e vallëzimit	200
4	Bandat muzikore	125-400
5	Roja (për 3 orë)	3
6	Sigurimi (për 3 orë)	12
7	Skena (për m <sup>2</sup> , me fuqinë punëtore për montim)	10
8	Marrja me qira e kinemasë	400
9	Marrja me qira e sallës së Universitetit	500
10	Marrja me qira e Sallës së Sporteve	500-1000
11	Marrja me qira e kafeneve/restoranteve. (përfshirë pijet/ushqimin për 20-40 njerëz)	200-400
12	Marrja me qira e Shtëpisë së Kulturës	200
13	Marrja me qira e Stadiumit	1000-1500
14	Marrja me qira e një automobili (në ditë)	60
15	Marrja me qira e një autobusi (në ditë)	80
16	Marrja me qira e një kamioni (në ditë)	70
17	Marrja me qira e një automjeti 4X4 (në ditë)	90
18	Marrja me qira e një minibusi (në ditë)	70

Janë marrë shpenzimet e njëjta mesatare për tubim për t'i llogaritur shpenzimet e përgjithshme të secilit subjekt politik të vërtetuar, përveç LDK-së, PDK-së dhe AAK-së. Ky përjashtim është bërë me qëllim që shpenzimet e këtyre subjekteve të llogariten veçmas, meqë, siç është konfirmuar nga raporti i shpenzimeve për fushatën e zgjedhjeve të vitit 2001 për Kuvendin e Kosovës, këto subjekte kanë treguar tendencë për të shpenzuar më shumë para se subjektet e tjera.


### Llogaritja e shpenzimeve të përgjithshme të tubimeve të organizuara nga subjektet politike

	Llogaritja mesatare e shpenzimeve të tubimeve (€)	Numri i tubimeve të organizuara (€)	Llogaritja mesatare e shpenzimeve të tubimeve (€)
AAK-ja	378	114	58,092
BK-ja	604	5	3,020
BSDAK-ja	350	1	350
DPP-ja	554	1	554
DSS-ja	280	2	560
GIG-ja	220	4	880
IRDK-ja	232	4	928
KDTP-ja	466	4	2314
KOS-ja	402	2	804
LDK-ja	785	277	257,645
LKÇK-ja	275	9	2,675
LPK-ja	580	8	4,640
PD-ja	406	8	3,348

<i>PDAK-ja</i>	225	2	450
<i>PDASHK-ja</i>	899	4	3,596
<i>PDK-ja</i>	477	298	167,746
<i>PKM-ja</i>	300	10	3,000
<i>PLK-ja</i>	631	14	9,234
<i>PREK-u</i>	918	8	10,944
<i>PSHDK-ja</i>	474	8	3,792
<i>SNV-ja</i>	220	3	960
<i>SSZ-ja</i>	280	1	280
<i>UDGJ-ja</i>	364	3	1,092
<i>VATAN-i</i>	240	11	2,640
<i>Gjithsej</i>			539,544

Edhe pse vlerat e lartshënuara të Njesisë së Revizionit dëshmojnë se në tubime janë shpenzuar rreth 539,544 €, subjektet politike pretendojnë se këto shpenzime të përgjithshme arrijnë shumën vetëm në 129,500 €.

### Subjektet politike që kanë shpenzuar mbi 5,000 € në tubime gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve - sipas Njesisë së Revizionit.



Përfundimisht, për tubimet e organizuara nga shumica e subjekteve politike në vende të tjera, përveç shtëpive private, nevojiten pajisje të veçanta, si skena, sisteme të zërimit (përfshirë mikrofonat, zmadhuesit, kabllot dhe mikserët e zërit), roje dhe personel i sigurimit. Po ashtu, qiraja është dashur të paguhet, e nëse jo, konsiderohet si kontribut me mall.

#### 4.5 Marrja e zyrave me qira

Vetëm dy subjekte pohojnë se kanë zyra çfarëdo qofshin. Prandaj, zyrat e tjera duhet të merren me qira ose të sigurohen pa pagesë nga anëtarët ose përkrahësit e subjekteve politike. Të gjitha subjektet e mëdha kanë degë ose nëndegë në gjithë Kosovën. Njësia e Revizionit beson se kjo vlen për një numër subjektësh me madhësi mesatare. Jo të gjitha subjektet politike kanë deklaruar

se kanë bërë shpenzime për zyrat e degëve apo të selive të tyre. Në llogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme për subjekt, Njësia e Revizionit ka shtuar një qira formale për zyra për shumicën e subjekteve që kanë marrë pjesë në zgjedhje. Arsyet për shtimin e kësaj qiraje formale janë:

1. Një numër i madh i subjekteve pohojnë se kanë pajisje për zyra;
2. Pjesëmarrja në zgjedhjet komunale kërkon patjetër një punë të madhe të subjektit politik dhe kjo punë duhet të kryhet diku.

Njësia e Revizionit mendon se kjo punë është bërë nga një numër i konsiderueshëm i njerëzve në tërë Kosovën. Prandaj, është shtuar një shumë nominale për rroga, shpenzime të telefonit dhe shërbime të tjera. Subjektet kanë argumentuar se kjo shumë nuk është paguar asnjëherë, gjë që mund të jetë e vërtetë. Zyrat e dhëna pa pagesë, puna e papaguar, faturat e papranuara të telefonit, janë kontribute me mall, prandaj edhe pjesë e të hyrave dhe të dalave. Çmimet që zbatohen nga Njësia e Revizionit, sipas burimeve tona, janë çmime standarde për marrjen e zyrave me qira.

Përveç kësaj, njëri nga subjektet politike, LKÇK-ja, nuk pohon se paguan qira për përdorimin e zyrave të veta në Prishtinë, as që pohon se e posedon ndërtesën në fjalë. Ky subjekt nuk e ka dorëzuar as kontratën e qirasë.

#### 4.6 Materiali i shtypur dhe reklamat

Të 68 subjektet politike të vërtetuara pohojnë se kanë shpenzuar gjithsej 203,600 € për shtypjen e materialeve dhe për reklama. Shumë subjekte politike kanë shtypur dhjetëra mijëra posterë dhe kanë shpërndarë falas, *mes tjerash*, artikuj si flamuj, shkrepësa, konatare dhe stilolapsa. Për çudi, sipas informatave që i kemi marrë nga burimet tona, vetëm një numër i vogël i subjekteve politike kanë shpenzuar pak para për reklama në gazeta dhe revista.

Katër subjekte politike kanë nxjerrë reklama në pllakate dhe i kanë vënë ato në Prishtinë në fazat e vonshme të periudhës së fushatës së zgjedhjeve. Njësia e Revizionit mendon se vetëm AAK-ja dhe PReK-u e kanë publikuar këtë informatë.

#### 4.7 Stafi

Tri partitë më të mëdha shqiptare deklarojnë se kanë zvogëluar operacionet e tyre në zyret kryesore gjatë vitit 2002. Për zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës në vitin 2001, LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja kanë pohuar se kanë të punësuar përkatësisht 96, 43 dhe 12 persona me orar të plotë. Shifrat për sivjet janë 10, 29 dhe 8 për të njëjtat subjekte. LDK-ja pohon se i paguan nëpunësit e vet, PDK-ja deklaron se ua ka borxh pagat, ndërsa AAK-ja deklaron se puna që bëhet nuk paguhet.

Tatimi mbi të ardhurat personale ka hyrë në fuqi në Kosovë që më 1 prill 2002. Të gjitha subjektet politike që punësojnë njerëz konsiderohen punëdhënës sipas rregulloreve dhe udhëzimeve administrative të UNMIK-ut. Punëdhënësi ka obligim të zbresë tatimin mbi të ardhurat personale nga nëpunësit, të cilët pohon se i paguan, dhe këtë shumë t'ua paguajë autoriteteve të tatimit. LDK-ja nuk mbledh fare tatim nga nëpunësit, për të cilët kjo parti pohon se i paguan, e as që ia paguan autoriteteve të taksave. LDK-ja madje as që është e regjistruar në autoritetet e tatimit për këto qëllime. PDK-ja është e regjistruar në autoritetet e tatimit, por nuk ka paguar ende fare tatim të mbledhur, siç thonë autoritetet e tatimit. AAK-ja nuk është regjistruar tek autoritetet e tatimit, por në të njëjtën kohë deklaron se nuk paguan asnjë pagë. Subjekti i vetëm politik që e mbledh tatimin nga nëpunësit e tij është PLK-ja. Sipas deklaratave mbi publikimin e financave, ky subjekt ende nuk e ka paguar tatimin e mbledhur.

Çështja e shpenzimeve për stafin është një çështje për të cilën shumica e subjekteve, në raportet e tyre, i kanë zvogëluar shpenzimet. Vetëm një numër i vogël subjektësh kanë deklaruar se kanë nëpunës në degë, apo edhe në selinë qendrore. Mendimi i Njesisë së Revizionit është se duhet të jetë dikush që organizon aktivitetet e subjekteve dhe që shërben si person për kontakte. Zvogëlimi i numrit të nëpunësve të LDK-së nga 96 në 10 nëpunës me orar të plotë nuk është i besueshëm për revizorët, kur të merret parasysh shtrirja e aktiviteteve të LDK-së gjatë fushatës. Është po ashtu vështirë të besohet se në zyret qendrore të AAK-së punojnë vetëm tetë persona. PDK-ja dhe shumë subjekte të tjera të vogla janë më të besueshme sa u përket njerëzve të punësuar. Ata e kuptojnë dhe e pranojnë konceptin e stafit të papaguar që dhuron kohën si kontribut me mall. Është jo bindëse që subjektet e madhësisë së LDK-së dhe AAK-së dhe të një numri të degëve që veprojnë të mund t'i zhvillojnë fushatat e tyre me thuaja numër të njëjtë të stafit si të partive shumë më të vogla që veprojnë në nivel të ngjashëm të infrastrukturës në tërë Kosovën.

#### 4.8 Vëzhguesit

Njësia e Revizionit mendon se shërbimet e vëzhguesve politikë i japin përfitim partisë qofshin të paguar ose të papaguar. Mesatarisht, supozohet se çdo vëzhgues politik ka kaluar dy ditë pune normale (nga 8 orë). Vlera e kësaj pune është caktuar 20 € Ky shpenzim mesatar është caktuar nga revizorët për vlerësimin e shpenzimeve, për të gjithë vëzhguesit e akredituar të sponsorizuar nga subjektet politike. Duhet të ceket se disa subjekte mund t'i paguajnë vëzhguesit e tyre më shumë se kjo shumë. Edhe nëse subjekti nuk paguan vëzhguesit e vet, ai duhet ta konsiderojë punën e tyre si kontribut të kohës së tyre dhe për këtë arsye, kjo punë duhet të llogaritet.

#### 4.9 Transporti

Sipas Qendrës për regjistrimin e automjeteve, vetëm dy subjekte politike posedojnë automjete. LDK-ja është regjistruar se i posedon 16 automjete, nga të cilat Kryetari i Kosovës i përdor dy, ndërsa PDK-ja posedon një automjet. Njësia e Revizionit mendon se selitë qendrore dhe degët e të gjitha subjekteve kanë pasur beneficinin e përdorimit të automjeteve gjatë periudhës së fushatës, qoftë duke i marrë me qira, qoftë duke i siguruar nga anëtarët apo përkrahësit e tyre. Pa marrë parasysh mënyrën se sigurohet automjeti, shfrytëzimi i tij paraqet element shpenzimi. Sa për PDK-në, Njësia e Revizionit ka caktuar 50 € për marrjen me qira të automjetit për një ditë. Njësia e Revizionit po ashtu ka shtuar një shumë të caktuar për shpenzimet për lëndë djegëse dhe vozitës.

### 5. Analiza sipas subjekteve

Në këtë pjesë do të përfshihen raportet e publikimit financiar të dymbëdhjetë nga 68 subjekte politike. Shifrat për subjektet që nuk janë përfshirë në këtë pjesë mund të gjenden në shtojcën C. LDK-ja, AAK-ja, PDK-ja, PK-ja dhe DSS-ja janë zgjedhur për përfshirje të hollësishme sepse këto subjekte kanë marrë numrin më të lartë të votave në komunitetet e tyre përkatëse. KDTP-ja, VATAN-i, IRDK-ja dhe SNV-ja janë zgjedhur përfaqësuese të komuniteteve etnike joshqiptare. PReK-u është marrë për të treguar shpenzimet e fushatës së partisë së vogël politike dhe Riza Lluca, i cili është zgjedhur në Pejë, është zgjedhur nga kandidatët e pavarur. Në fund, edhe pse partia nuk e ka fituar asnjë vend, LKÇK-ja është përfshirë në këtë pjesë për shkak të interesit për njohjen dhe zbulimin e të hyrave dhe të dalave të shfrytëzuara nga partia që ka deklaruar se do t'i bojkotojë zgjedhjet.

Parametrat e analizuar, siç përcaktohen me Rregullën e Zgjedhjeve 5/2002, mbi publikimin financiar të fushatës dhe kufirin e shpenzimeve, mund të gjenden në shtojcën A.

## 5.1 LDK-ja

Personi i financave për kontakte	Fatmir Rexhepi <sup>2</sup>
Kandidatë të zgjedhur	406
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	29/28

### FORMULARËT DHE DOKUMENTET E DORËZUARA

Për periudhën e dytë dhe përfundimtare të publikimit financiar LDK-ja ka dorëzuar Formularin 308<sup>3</sup> për selinë qendrore dhe për 28 komuna. Raporti i degës së Komunës së Kamenicës ishte kopje e raportit të dorëzuar për periudhën e parë raportuese dhe për këtë arsye nuk është pranuar nga Njësia e Revizionit. Raportet e 8 komunave nga 28 komuna dhe nga njëra prej pesë degëve të Prishtinës janë dorëzuar pas afatit. Njësia e Revizionit ka parashtruar një ankesë në NKZPA përkitazi me këtë dorëzim të vonë.

LDK-ja ka siguruar dokumentacionin përkrahës dhe librat e kontabilitetit për të dalat e paraqitura të selisë qendrore. Megjithatë, për degët komunale nuk është marrë kurrfarë dokumentacioni i tillë dhe asnjë libër i kontabilitetit.

### MJETET

Në fund të periudhës së fushatës, LDK-ja ka deklaruar mjete me vlerë prej 619,643 €.

LDK-ja është njëra ndër subjektet e pakta politike e cila deklaron se posedon pronë, duke publikuar pronësinë e selisë së tyre dhe të rezidencës së kryetarit të partisë. Edhe pse është përsëritur kërkesa, LDK-ja nuk i ka dorëzuar Njesisë së Revizionit kopjen e dokumenteve për të drejtën e pronës që posedon. Megjithatë, sa i përket pronësisë së zyreve të Selisë qendrore të LDK-së, zyrtarët e Departamentit të UNMIK-ut për Menaxhimin e Ndërtesave Publike i konsiderojnë këto zyre pjesë të ndërtesave publike: Galeria e Qafës.

Selia qendrore e LDK-së ka publikuar se posedon katër automjete. Përkundër kësaj, Regjistri i automjeteve të Kosovës ka të dhëna për dhjetë automjete, të regjistruara në emër dhe adresë të LDK-së në Prishtinë (dy nga të cilat shfrytëzohen nga Kryetari i Kosovës). Shifrat e Regjistrimit gjithashtu përputhen me numrin e automjeteve për të cilat LDK-ja paguan karburante. Gjithashtu, 14 degë të komunës deklarojnë se posedojnë 18 automjete. Regjistri i automjeteve ka të dhëna për vetëm katër automjete të regjistruara në emër të LDK-së jashtë Prishtinës.

Së bashku me Selinë qendrore të LDK-së, 22 degë komunale kanë shpallur pronësinë e pajisjeve të zyrës.

Njësia e Revizionit i ka pranuar të gjitha shifrat si mjete të LDK-së, të Selisë qendrore dhe të degëve komunale. Megjithatë, duhet të theksohet se Njësia e Revizionit ka dyshime të arsyeshme përkitazi me pronësinë e zyreve (për Selinë qendrore) si dhe për numrin e automjeteve dhe vlerës së paraqitur.

### BORXHET

<sup>2</sup> Z. Rexhepi ka refuzuar t'i nënshkruajë raportet e dorëzuara nga degët. Supozohet se kjo nuk është në përputhje me Statutin e LDK-së. Sipas Rregullës së Zgjedhjeve 5/2002, personi i financave për kontakte është i vetmi përgjegjës për të raportuar te Njësia e Revizionit dhe për këtë arsye duhet ta nënshkruajë raportin. Në këtë bazë, LDK-ja e shkel atë Rregull të Zgjedhjeve.

<sup>3</sup> Formulari 308 mund të merret në Zyrën e Shërbimit të Partive Politike të DOZ-it.

LDK-ja ka raportuar borxhe prej 57,254 €. Njësia e Revizionit konsideron se shuma e deklaruar është padyshim e pasaktë. Siç do të theksohet më vonë në këtë pjesë, llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) dhe/ose të hyrat do të duhej të rriteshin shumë për t'i bilacuar llogaritë e LDK-së.

#### TË HYRAT

Të hyrat e përgjithshme për periudhën e fushatës deklarohen të jenë 198,959 €, nga të cilat 138,047 € vijnë nga kontributet monetare, 58,702 € nga tarifa e anëtarësisë dhe 1,210 € nga kontributet me mall.

Pjesa më e madhe e shumës e publikuar si tarifë e anëtarësisë, 46,240 €, është paraqitur nga Selia qendrore dhe vjen nga diaspora. Statusi i diasporës së LDK-së duket i paqartë dhe ka arsye për konfuzion. Edhe pse të privuara nga të drejtat e anëtarësisë, këto grupe i paguajnë rregullisht tarifa e anëtarësisë.

Një pjesë e rëndësishme e donacioneve monetare të raportuara, 53,733 €, nuk janë regjistruar në pajtim me Rregullën e Zgjedhjeve 5/2002, meqë nuk është identifikuar burimi i donacioneve. Pas tjerash, paratë e marra nga grupet e diasporës duhet të regjistrohen si donacione të partisë e jo si tarifë e anëtarësisë. Të hyrat ose llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) do të duhej të rriteshin bukur shumë për ta kthyer bilancin në llogaritë e LDK-së. Prandaj, Njësia e Revizionit konsideron se shuma e deklaruar e të hyrave pa kurrfarë dyshimi nuk është e saktë.

#### SHPENZIMET

##### a. Pllakatet

Selia qendrore e LDK-së deklaron për shpenzimet prej 840 € për dizajnin dhe prodhimin e pllakateve si dhe për marrjen me qira të mbajtëseve të pllakateve. Mendimi i Njësisë së Revizionit është se LDK-ja ka paraqitur shpenzime në vlerë më të ultë për 5,360 € për pllakate. Për degët e saj LDK-ja deklaron të kenë shpenzuar 6,555 €. Po ashtu besohet se, në shumicën e rasteve, shifrat e deklaruara paraqesin paratë e shpenzuara për material tjetër të shtypur. Duke mos e siguruar dokumentacionin përkrahës të kërkuar për raport, LDK-ja e ka penguar Njësinë e Revizionit të korrigjojë gabimin e mundshëm.

b. Materiale të tjera të shtypura/shpërdarjet falas/prodhimi i spoteve televizive dhe të radios.

Njësia e Revizionit i pranon shifrat e publikuara prej 40,334 €.

##### c. Shpalljet në gazeta

LDK-ja deklaron të ketë shpenzuar 3,304 € për shpalljet në gazeta. Njësia e Revizionit pajtohet me LDK-në nga ajo që është raportuar prej degëve përkitazi me këtë artikull, por nuk pajtohet plotësisht për shifrën për Selinë qendrore. Sipas vlerësimeve të bëra nga revizorët, të dalat përfundimtare për shpalljet në gazeta do të ishin 915 € e jo sa shuma e deklaruar prej 534 €.

##### d. Tubimet

LDK-ja raporton për të dalat prej 55,401 € (12,450 € për Selinë qendrore dhe 42,951 € për komunat e tjera) për tubimet në gjithë Kosovën. Nga Selia e saj qendrore Njësia e Revizionit ka marrë vetëm dëftesa për artistët, për sigurimin dhe marrjen me qira të vendit të tubimeve. Shumica e këtyre artikujve u referohen tubimeve të mbajtura në Prishtinë më 21 shtator dhe 24 shtator. Siç u deklarua më lartë, Njësia e Revizionit nuk ka marrë asnjë dokumentacion për

përkrahjen e asnjë dege, dhe për këtë arsye është mjaft vështirë të vlerësohet saktësisht pa informata të tilla.

Sipas shënimeve nga POLICIA E UNMIK-ut, LDK-ja ka mbajtur 277 tubime gjatë periudhës së fushatës. Duke marrë parasysh edhe informacionin e siguruar nga organizatat e vëzhguesve të akredituar, këto tubime janë ndjekur në përgjithësi mirë dhe janë përgatitur me numër adekuat të sigurimit dhe të rojeve. Në disa raste, vëzhguesit kanë raportuar se në tubimet e mbajtura nga LDK-ja kanë punuar 50 deri 60 anëtarë të personelit të sigurisë.

Njësia e Revizionit konsideron se LDK-ja i ka shpenzuar 257,645 € për tubime. Për shkak të mungesës së informatave të sigurta nga LDK-ja, janë shfrytëzuar llogaritjet standarde të shpenzimeve të tubimeve. Për këtë arsye Njësia e Revizionit mendon se LDK-ja ka paraqitur shumën prej 202,244 € më të ultë si nga të hyrat ashtu edhe nga të dalat e veta.

#### e. Transporti

LDK-ja deklaron të ketë shpenzuar 20,479 € për transportim gjatë periudhës së fushatës për 22 automjetet e paraqitura. Selia qendrore ka raportuar të dalat prej 3,985 € për karburante për 10 automjete. Pos tjerash, 6,000 € janë paraqitur si rroga të vozitësve. Disa degë që kanë automjete nuk kanë paraqitur fare shpenzime për karburante e as për vozitës. Aty ku informata nuk ishte e plotë, Njësia e Revizionit i ka llogaritur shpenzimet që mungojnë. Për transportim, janë shtuar gjithsej 12,640 €.

#### f. Reprerentacioni

LDK-ja deklaron të ketë shpenzuar 33,784 € për reprerentacion.

Komunave me formularë të zbrazët dhe pa shënime të paraqitura, u është shtuar një shifër formale për shpenzimet e tilla për të vlerësuar shpenzimet e përgjithshme të LDK-së. Shuma e vlerësuar është gjithsej 1,300 €.

#### g. Marrja me qira e zyreve për mbledhje

LDK-ja nuk ka paraqitur asnjë shpenzim për marrje me qira të lokaleve për mbledhje. Megjithatë, Njësia e Revizionit ka shënime për mbajtjen e 11 konferencave të shtypit dhe për mbledhje të tjera të LDK-së nëpër Kosovë gjatë periudhës së fushatës. Sipa kësaj, është shtuar shpenzimi prej 2,200 € për të vlerësuar shpenzimet e përgjithshme të LDK-së.

#### h. Vëzhguesit politikë të paguar

LDK-ja deklaron të ketë shpenzuar 34,571 € për vëzhguesit politikë. Nuk i kanë regjistruar të gjitha komunat të dalat e tyre, kështu që shuma për vëzhgues sigurisht dallon shumë. LDK-ja nuk i ka siguruar Njësisë së Revizionit kurrfarë dokumentacioni për të dëshmuar fakte të sakta. Njësia e Revizionit e vlerëson punën e bërë nga vëzhguesit politikë të dobishme për partinë, pa marrë parasysh nëse janë paguar ose jo. LDK-ja i ka akredituar 3,417 vëzhgues. Vlera e vëzhguesve politikë të LDK-së është llogaritur të jetë 68,340 €.

#### i. Shpenzime të përgjithshme

LDK-ja deklaron të ketë pasur 36,466 € si shpenzime të përgjithshme, nga të cilat 22,665 € kanë të bëjnë me Selinë qendrore, dhe pjesa tjetër prej 13,801 € për 28 degët e saj. Mesatarisht, kjo do të ishte 493 € për degë.



Selia qendrore e LDK-së ka raportuar për punësimin e 10 njerëzve, edhe pse rogat nuk janë paraqitur. Nga procesverbali i Kuvendit të Partisë i mbajtur sivjet, rroga mesatare është 250 € në muaj. Revizorët e kanë shtuar këtë për 1.5 muaj për 10 njerëz. Selia qendrore ka paraqitur edhe 559 € të shpenzuara për llogaritë e telefonit gjatë periudhës së fushatës. Njësia e Revizionit, megjithatë, vlerëson se kjo shifër është 4,000 €. Nuk është shënuar asnjë pagesë për qira të zyreve kryesore, edhe pse ka pak dyshim nëse LDK-ja është pronar ligjor i Selisë qendrore.

Sa u përket degëve të LDK-së, vetëm nëntë nga to kanë paraqitur se kanë marrë zyre me qira. Mirëpo, 24 degë deklarojnë se posedojnë pajisje të zyrës. Njësia e Revizionit konsideron se kjo pajisje zakonisht mbahet në zyrë. Prandaj revizorët kanë shtuar shumën e qirasë së zyrës për 19 degët e tjera për të vlerësuar të dalat e LDK-së. LDK-ja ka paraqitur 375 € për rroga në 28 komuna që marrin pjesë në zgjedhje. Njësia e Revizionit konsideron se një numër i madh njerëzish punojnë në këto zyre, qoftë me pagë ose pa pagë, duke bërë shërbime për partinë. Në mungesë të shënimeve nga LDK-ja, revizorët kanë vlerësuar gjithsej 68,488 € për rroga, telefona, për shërbime dhe shpenzime të tjera të përgjithshme.

Nga raporti i dorëzuar nga Selia qendrore, revizorët kanë konstatuar se LDK-ja ka paguar 2,233 € për rrymën elektrike të një personi me emër. Është zbuluar se ai person nuk është anëtar i kryesisë së LDK-së dhe nuk ka asnjë pozitë me rëndësi brenda partisë. Edhe po të kishte, kjo do të konsiderohej si shkelje e nenit 5.5 të Rregullës së UNMIK-ut 2002/8, ku thuhet *“Partia politike nuk do të shpërndajë fare të hyra ose mjete si të tilla asnjë personi. Mjetet dhe të hyrat e partisë politike do të shfrytëzohen për t’i përkrahur qëllimet politike joprofitabile për partinë politike dhe nuk do të shfrytëzohen për të siguruar fitime, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, asnjë anëtar i partisë politike, organ i saj ekzekutiv ose donator i partisë politike. Ai nen nuk e parandalon pagesën e kompensimit të arsyeshëm të personit të tillë për punën e kryer për partinë politike”*. LDK-ja ka shpenzuar edhe 1,700 € për ta ndihmuar një familje të pidentifikuar.

LDK-ja nuk është regjistruar për taksa të të ardhurave personale të punëtorëve të vet, dhe prandaj nuk e zbrit asnjë taksë nga rroga, as për personelin administrativ, kryesinë ose ndonjë punëtor tjetër.

## PËRFUNDIM

Mendimi i Njesisë së Revizionit është që LDK-ja i ka paraqitura të dalat e saj në vlera më të ulta për 326,381 €. Për shkak të mungesës së dokumentacionit përkrahës të siguruar nga subjekti, Njësia e Revizionit nuk mund të përcaktojë nëse kjo mospërputhje është borxh, është paguar ose konsiderohet si kontribut me mall. Meqë LDK-ja i ka deklaruar borxhet e veta, ka shumë gjasa që alternativat janë të hyrat të paraqitura me vlerë më të ulët të parave ose të kontributeve me mall. Shuma që nuk përputhet midis mjeteve dhe borxheve/saldos në fund të periudhës raportuese është 321,406 €. Njësia e Revizionit konsideron se ky subjekt e ka paraqitur shumën e të hyrave në vlerë më të ulët.

## 5.2 PDK

Personi i financave për kontakte	Adem Zogijani
Kandidatë të zgjedhur	283
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	28/28

## FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE TË DORËZUARA

Për periudhën e dytë dhe përfundimtar të publikimit financave, PDK-ja ka dorëzuar Formularin 308 për selitë e veta dhe për 26 degët komunale. Raportet për degët komunale në Kamenicë dhe

Dragash nuk janë dorëzuar. Dokumentacioni mbështetës dhe kopja e librit të kontabilitetit për selitë nuk është dorëzuar. Edhe pse dokumentacioni i pjesëshëm është dorëzuar për disa degë. SHPP-ja ka parashtruar ankesë kundër PDK-së për dorëzimin me vonesë për disa degë dhe për mosdorëzim për degët e tjera.

## MJETET

PDK-ja ka deklaruar mjete në vlerë prej 162,672 €, përveç parave të gatshme, llogarive bankare dhe llogarive të pranuar. Njësia e Revizionit i konsideron të pranueshme shifrat e cekura nga PDK-ja si mjete të selisë së saj kryesore dhe degët komunale. Megjithatë duhet të theksohet se revizorët kanë dyshime të arsyeshme përkitazi me pronësinë e zyrave të degëve të paraqitura si pronë e PDK-së dhe për një numër të automjeteve duke përfshirë vlerën e tyre. Sa i përket regjistrimit të automjeteve, PDK-ja ka në pronësi vetëm një automjet, në Prizren. Kurse, në raportin e fushatës të PDK-së publikohen gjashtë automjete.

## BORXHET

Në fund të periudhës së fushatës, selia kryesore e PDK-së dhe njëmbëdhjetë degët e veta komunale kanë deklaruar borxhe të përgjithshme në vlerë prej 23,591 €. Ose borxhet ose të hyrat duhet të rriten në masë të konsiderueshme për t'i balancuar llogaritë e PDK-së.

## TË HYRAT

PDK-ja ka paraqitur të hyra të përgjithshme në vlerë prej 126,700 €, prej të cilave 5,766 € vijnë nga tarifat e anëtarësisë. Pjesa e mbetur 120,934 € është publikuar si donacione në të holla (89,492 €) dhe kontribute me mall dhe shërbime (31,442 €). Burimet e donatorëve dhe kontribuesve janë bërë publike, në përputhje me Rregullën e Zgjedhjeve 2002/05 (shih shtojcën D). Të hyrat dhe borxhet duhet të rriten në masë të konsiderueshme për t'i balancuar llogaritë e PDK-së. Njësia e Revizionit nuk ka dyshim se të hyrat e raportuara janë të pasakta.

## SHPENZIMET

### a. Pllakatet

Selia kryesore e PDK-së deklaroi se i ka harxhuar 530 € për dizajnimin, përgatitjen e pllakatave dhe marrjen me qira të stendave për pllakate. Për degët e veta PDK-ja pohon se i ka shpenzuar 3,355 €. Njësia e Revizionit i konsideron si të pranueshme shifrat e paraqitura nga degët komunale të PDK-së. Megjithatë, sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, PDK-ja ka të dala të raportuara më pak për 8,010 € për pllakatet për selinë e vet kryesore.

### b. Materialet e tjera të shtypura

Për këtë artikull PDK-ja deklaroi se ka shpenzuar 8,464 €. Për degët, Njësia e Revizionit i pranon shifrat e paraqitura nga PDK-ja, por nuk pajtohet me shifrat e paraqitura nga Selia kryesore e këtij subjekti. Duke mos i siguruar Njesisë së Revizionit dokumentacion mbështetës, PDK-ja ka penguar revizorët nga korrigjimi i gabimeve të mundshme. Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, PDK-ja ka të dala të paraqitura më pak deri 8,098 € për materialet e tjera të shtypura.

### c. Tubimet

PDK-ja deklaroi se ka shpenzuar 21,512 €, 6,370 € nga selia e vet kryesore dhe 15,142 € nga degët e ndryshme nëpër tubimet në mbarë Kosovën. Siç e përmendëm më lartë, Njësia e

Revizionit nuk ka marrë asnjë dokumentacion mbështetës çfarëdoqoftë ai prej Selisë kryesore, kështu që është e pamundshme të bëhet vlerësimi i saktë nga shifrat e cekura. Vetëm disa dëftesa u dorëzuan nga disa degë përkitazi me shpenzimet për artistët dhe zërimin.

Sipas dosjeve të POLICISË së UNMIK-ut, PDK-ja ka mbajtur 298 tubime gjatë periudhës së fushatës. Duke marrë parasysh edhe informatat e siguruara nga organizatat e akredituara të vëzhgimit, këto tubime në përgjithësi kanë pasur pjesëmarrje të mirë dhe prezentim të mirë dhe u organizuan në mënyrë profesionale me një numër adekuat të personelit të sigurimit.

Tubimet e PDK-së gjatë periudhës së fushatës së zgjedhjeve janë mbajtur nëpër salla të sportit, stadione, shkolla, shtëpi private dhe në hapësirë të hapur. Tubimet e mbajtura në vende të tjera, përveç shtëpive private, kërkonin pajisje të posaçme si p.sh. skenat, sistemet e zërimit (duke përfshirë mikrofonët, autoparlantët, kabllot dhe miksetat e zërit) dhe personelin e sigurimit. Përveç tjerash, qiraja është dashur të paguhet ose, nëse nuk është paguar, duhet të publikohej si kontribut me mall dhe shërbime.

Njësia e Revizionit konsideron se PDK-ja ka shpenzuar 167,746 € për tubime. Për shkak të mungesës së informatave të besueshme nga PDK-ja, janë aplikuar vlerësimet standarde të revizorëve për kostot e tubimeve.

#### d. Transporti

PDK-ja deklaron se ka shpenzuar 19,038 € për transport gjatë periudhës së fushatës për 6 automjetet e veta të raportuara. Numri i automjeteve të përdorura nga partia ishte njëmbëdhjetë. Shumë degë kanë paraqitur koston e lëndëve djegëse pa ndonjë kosto për automjetet ose shoferët. Kur informatat ishin të pasakta, revizorët e llogaritën koston e papublikuar. Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, PDK-ja ka paraqitur më pak koston e transportit gjatë fushatës së zgjedhjeve për 26,904 €. Kostoja e përgjithshme e transportit, duhet të jetë, sipas revizorëve 45,942 €.

#### e. Marrja me qira e sallave për mbledhje

PDK-ja nuk ka raportuar asnjë shpenzim për marrjen me qira të sallave për mbledhje. Njësia e Revizionit ka shënime nga burime të ndryshme të informimit siç është përshkruar më lartë, për mbajtjen e 13 konferencave për shtyp dhe mbledhjeve të tjera nga PDK-ja në mbarë Kosovën gjatë periudhës së fushatës. Asnjëra prej tyre nuk është raportuar nga PDK-ja. Kostot e mbledhjeve të tilla janë vlerësuar nga revizorët të jenë në vlerë prej 2,600 €.

#### f. Vëzhguesit politikë të paguar.

PDK-ja deklaron se ka shpenzuar 12,347 € për vëzhguesit politik. Jo të gjitha komunat kanë marrë shënime për çfarëdo shpenzimesh, dhe shuma për një vëzhgues ndryshon për secilën degë. Njësia e Revizionit beson se nga puna e vëzhguesve politik përfiton partia, pa marrë parasysh se a është paguar apo jo. PDK-ja ka akredituar 2,782 vëzhgues. Revizorët kanë caktuar vlerën e punës së kryer nga vëzhguesit politikë në 55,640 €.

#### g. Shpenzime të përgjithshme

PDK-ja deklaron se ka shpenzuar 42,672 € për shpenzime të përgjithshme, prej të cilave 23,791 € i takojnë Selisë kryesore, kurse pjesa tjetër 18,880 € u takon 26 degëve. Mesatarisht, do të thotë 726 € për një degë.

Selia kryesore e PDK-së ka raportuar t'i ketë punësuar 29 persona dhe ka shpenzuar 13,090 € për paga, gjithsej shpenzime të përgjithshme 23,731 €. Njësia e Revizionit i konsideron këto shifra si të pranueshme.

Sa u përket degëve të PDK-së, vetëm 13 degë kanë raportuar marrjen me qira të zyrave. Kurse, 28 degë deklarojnë se kanë në pronësi pajisje të zyrës. Njësia e Revizionit beson se këto pajisje po mbahen në zyrë. Për këtë arsye Njësia e Revizionit ka shtuar qiranë për zyra për 15 degët e mbetura, me qëllim të vlerësimit të të dalave të përgjithshme. PDK-ja ka raportuar 3,700 € për paga, për 28 komunat në të cilat kanë marrë pjesë në zgjedhje. Gjithashtu Njësia e Revizionit beson fuqimisht se në këto zyra punon një numër i madh i njerëzve, me pagesë apo papagesë, por që i ofrojnë shërbime partisë. Njësia e Revizionit ka shtuar gjithsej 18,880 €.

## KONKLUDIM

Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, PDK-ja ka paraqitur më pak të dala në vlerë deri 250,333 €. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës të paraqitur nga subjekti, Njësia e Revizionit nuk mund të konstatojë nëse kjo shumë që nuk përputhet ende është borxh, është paguar apo mund të konsiderohet si kontribut me mall dhe shërbime. Meqë PDK-ja i ka paraqitur borxhet e veta, atëherë ka më shumë gjasa që PDK-ja ka shuma të të hyrave në të holla ose kontribute me mall dhe shërbime të raportuara më pak. Kjo mospërputhje midis mjeteve dhe borxheve/ saldo në fund të periudhës së raportimit është 292,393 €. Njësia e Revizionit ka vlerësuar se shifra paraqet të hyrat që janë raportuar më pak nga subjekti.

## 5.3 AAK

Personi i financave për kontakte	Jahja Lluka
Kandidatë të zgjedhur	77
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	30/26

## FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONET MBËSHTETËSE TË DORËZUARA

AAK-ja ka dorëzuar Formularin 308 për Selinë kryesore dhe degët. Prej 26 degëve që i kanë dorëzuar, 15 i kanë dorëzuar me vonesë, kështu që i japin SHPP-së baza për të parashtruar ankesë pranë NKZPA-së. Njësia e Revizionit ka pranuar dokumentacion mbështetës për deklaratat e Selisë kryesore.

Edhe pse asnjë dokumentacion i tillë nuk është dorëzuar për shumë degë komunale. Megjithatë është kërkuar, nuk është dorëzuar as kopja e librave të kontabilitetit.

## MJETET

AAK-ja deklaron se ka në pronësi pajisje të zyrës në vlerë prej 30,685 €. Pronësia është e përbashkët midis Selisë kryesore dhe 19 degëve të saj. AAK-ja nuk ka raportuar pronësi mbi asnjë mjet tjetër.

Në shumicën e raporteve të AAK-së, si nga selitë ose degët, shifrat e dorëzuara për periudhën e parë të raportimit ndryshojnë prej shifrave të periudhës së dytë të raportimit. Për shembull, në deklaratën mbi publikimin e financave që përfshin periudhën 3 qershor-9 shtator, dega e AAK-së në Suharekë kishte deklaruar se ka në pronësi një automjet; kurse, në deklaratën e dytë mbi publikimin e financave që përfshin periudhën 10 shtator-26 tetor automjeti nuk është publikuar.

Që nga 17 nëntori 2001 AAK-ja kishte deklaruar se kishte në pronësi 198,300 DM (përafërsisht 100,000 €), prej të cilave 140,000 DM ishin të caktuara për automjete. Që nga 26 tetori 2002 AAK-

ja nuk deklarohet se ka në pronësi asnjë automjet, gjë që koïncidon me informacionin e marrë nga regjistrimi i automjeteve.

Njësia e Revizionit i ka pranuar të gjitha shifrat e paraqitura si mjete të AAK-së, si të Selisë kryesore ashtu edhe të degëve. Megjithatë duhet të vihet në dukje se ka shumë të ngjarë që pajisjet e zyrës të raportuara në pronësi në deklaratën e parë mbi publikimin e financave janë ende në pronësi në periudhën e dytë të raportimit.

## BORXHET

11 degë komunale dhe Selia kryesore kanë deklaruar se kanë borxhe në vlerë prej 14,720 €. Njësia e Revizionit nuk ka dyshim që shuma e theksuar e borxheve është e pasaktë. Siç përmendet më poshtë në këtë kapitull, llogaritë që duhet të paguhën (borxhet) ose të hyrat duhet të rriten në masë të konsiderueshme për të balancuar llogaritë e AAK-së.

## TË HYRAT

AAK-ja ka publikuar 79,921 € si të hyra për periudhën e raportimit.

AAK-ja deklarohet donacione në të holla në vlerë prej 47,867 €, dhe kontribute me mall dhe shërbime në vlerë prej 31,886 €. Në raport janë përfshirë edhe tarifat e anëtarësisë gjatë periudhës së fushatës në vlerë prej 168 €. Burimet e donacioneve në të holla si dhe kontributeve me mall dhe shërbime janë shqyrtuar dhe përputhen me Rregullën e Zgjedhjeve 5/2002.

Të hyrat ose llogaritë që duhet të paguhën (borxhet) do të duhet të rriten në masë të konsiderueshme për të balancuar sërish llogarinë e AAK-së. Në këtë mënyrë, Njësia e Revizionit nuk ka dyshim që shuma e publikuar e të hyrave është e pasaktë dhe e paraqitur më pak.

## SHPENZIMET

a. Pllakatet dhe materialet të tjera të shtypura.

AAK-ja deklarohet se ka shpenzuar 11,220 € për pllakate dhe materiale të tjera të shtypura. Shifrat e paraqitura nga AAK-ja janë shqyrtuar nga Njësia e Revizionit për të pasqyruar çmimet e tregut. Njësia e Revizionit beson se AAK-ja ka shtypur më shumë se 4,000 posterë, nga sa ka deklaruar. Numri është rritur deri në 20,000 posterë.

b. Artikujt e shpërndarë falas

AAK-ja raportohet shpenzime prej 120 € për artikujt që shpërndahen falas siç janë flamujt, lapsat, shkrepsat, bluza, etj. Njësia e Revizionit nuk e sheh si shumë të arsyeshme shifrën e raportuar. Revizorët kanë caktuar shumën prej 10,000 €.

c. Realizimi i TV/radio spoteve

AAK-ja deklarohet se ka shpenzuar 10,000 € për TV dhe Radio spotet. Në mesin e dokumentacioneve të dorëzuara, AAK-ja ka përfshirë edhe faturën për realizimin e dy TV-spotëve. Në bazë të informacioneve nga Monitorimi i Mediave i OMIK-ut, AAK-ja ka emetuar 4 TV-spotet të ndryshme. Prandaj Njësia e Revizionit ia ka shtuar shifrën së dorëzuar koston e realizimit për dy TV spotet më shumë.

d. Reklammat në gazeta

AAK-ja deklaron të ketë shpenzuar 619 € për reklama në gazeta. Sipas Monitorimit të Mediave të OMIK-ut, AAK-ja ka realizuar 13 reklama në gazeta. Çmimi i përgjithshëm, duke marrë parasysh madhësinë, ngjyrën dhe numrin e reklamave, është vlerësuar të jetë 3,125 €.

#### e. Tubimet

AAK-ja deklaron shpenzime prej 14,309 € (Selia kryesore 745, dhe komunat 13,564) për tubimet në mbarë Kosovën. Dokumentacioni mbështetës nga AAK-ja është i pamjaftueshëm, apo nuk ekziston.

Sipas dosjeve nga Policia e UNMIK-ut, AAK-ja ka mbajtur 114 tubime gjatë periudhës së fushatës. Tubimet janë mbajtur nëpër lokacione të ndryshme, siç janë sallat e sporteve, shtëpitë e kulturës, shkollat, shtëpitë private dhe vendet e hapura. Tubimet e organizuara në vende të tjera përveç shtëpive private kërkonin pajisje të veçanta si: skena, sistemi i zërimit (përfshirë mikrofonët, autoparlantët, kabllot dhe miksetat e zërit) dhe personelin e sigurimit. Përveç kësaj, qiraja është dashur të paguhet apo, nëse nuk është paguar, duhej të konsiderohej si kontribut me mall dhe shërbime.

Njësia e Revizionit ka marrë reagime prej vëzhguesve për një numër të madh të tubimeve të AAK-së, që sigurojnë informata të dobishme për të llogaritur koston e përafërsit të çdo tubimi. Meqë AAK-ja nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës përkitazi me këtë çështje, për të vlerësuar shpenzimet e tubimeve politike të raportuara janë përdorur burime alternative të informimit. Duke u bazuar në këto burime, shpenzimet e përgjithshme të AAK-së për tubimet janë vlerësuar të jenë 58,092 €.

#### f. Transporti

AAK-ja ka publikuar 17,722 € si kosto të transportit gjatë periudhës së fushatës, nga e cila shumë 3,780 € janë deklaruar për Selinë kryesore të partisë dhe 13,942 € për degët e partisë.

Meqë AAK-ja nuk ka në pronësi asnjë automjet, të gjitha automjetet e përdorura ose duhet të jenë marrë me qira ose janë siguruar nga anëtarët ose përkrahësit. Për subjektin politik, sa i përket llogaritjes së koston është e parëndësishme se në çfarë mënyre janë marrë automjetet, pasi që automjetet e dhuruara konsiderohen si kontribute me mall dhe shërbime. Thjesht, Njësia e Revizionit ka caktuar çmimin fiks për marrjen me qira të automjeteve të lehta, pavarësisht nga kompania prodhuese ose modeli, bile edhe në rastin e AAK-së, është publikuar përdorimi i 3 mercedesëve që janë pronë e kryetarit të partisë.

Selia kryesore e AAK-së deklaron se gjatë periudhës së fushatës ka shfrytëzuar tri automjete, të gjitha me benzinë. Sidoqoftë, mes dëftesave për karburant, ne kemi gjetur dëftesa për benzinë dhe naftë. Prandaj, Njësia e Revizionit beson se është përdorur së paku një automjet me naftë. Ngjashëm AAK-ja duhet të ketë pasur shofera për këto automjete, edhe pse kjo nuk është raportuar nga subjekti.

Për 9 degë të saj, AAK-ja ka raportuar vetëm karburante. Për konsumim të suksesshëm të këtij karburanti, atyre do t'u jenë nevojitur automjetet dhe shoferat. Njësia e Revizionit ka përfshirë marrjen me qira të automjeteve dhe rrogat e shoferave.

Për degët që kanë dorëzuar formularë të paplotësuar janë shtuar automjeti, karburanti dhe shoferi, në nivel të caktuar të pandryshueshëm. Në bazë të shifrave të dorëzuara, dokumentacionit mbështetës dhe informacionit për aktivitetet të tjera, Njësia e Revizionit ka vlerësuar se AAK-ja ka shpenzuar gjithsejt 59,167 € për transport.

#### g. Shpenzimet e reprezentacionit

AAK-ja ka raportuar 5,330 € shpenzime për pranime, ngjarje dhe darka. Njësia e Revizionit i konsideron të pranueshme shifrat e dorëzuara nga AAK-ja, përveç ato të degëve me formularë kryesisht të paplotësuar, në të cilët është përfshirë një shifër minimale për ushqim dhe pije.

#### h. Qiraja për salla të mbledhjeve

AAK-ja deklaron se ka shpenzuar 100 € për qiranë e sallave për mbledhje në mbarë Kosovën, për 45 ditët e periudhës së fushatës. Megjithatë, sipas raporteve të Monitorimit të Mediave, të OMIK-ut, gjatë periudhës së fushatës AAK-ja ka mbajtur 12 mbledhje të ndryshme dhe konferenca për shtyp. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës, kostoja e secilës nga këto ngjarje është vlerësuar në 200 € për një takim, duke e arritur vlerën e përgjithshme prej 2,400 €.

#### i. Vëzhguesit e paguar politikë

AAK-ja deklaron se ka shpenzuar 400 € për vëzhguesit e zgjedhjeve. Supozohet se vëzhguesit e zgjedhjeve janë në dobi të partisë, pavarësisht nga ajo se a paguhen apo jo. Mesatarisht, Njësia e Revizionit konsideron se secili vëzhgues i zgjedhjeve ka shpenzuar 2 ditë normale të punës (8 orë). Është caktuar vlera prej 20 € në ditë. AAK-ja ka akredituar 933 vëzhgues. Si rrjedhim, vlera e shpenzimeve për vëzhguesit politikë është llogaritur të jetë 18,660 €.

#### j. Shpenzimet e përgjithshme

AAK-ja deklaron se ka shpenzuar 23,122 € për shpenzime të përgjithshme gjatë periudhës së fushatës. Gjithashtu AAK-ja nuk ka deklaruar të dala në emër të qirasë për zyrat e saj ose për selinë e saj kryesore në Rrugën Nëna Terezë. Ajo ka kontratë të qirasë me Institutin e Pejës (Ministrinë e Bujqësisë), e cila përfshinë një klauzolë të pagesës. Kjo pagesë (qira) është vlerësuar të jetë 1200 €.

AAK-ja deklaron se ka në pronësi paisje për zyra në 19 degët e saj. Për disa nga këto degë AAK-ja ka paraqitur kontratat e qirasë. Megjithatë, për shumë prej tyre qiraja nuk është publikuar. Njësia e Revizionit beson fuqishëm se nëse dega ka në pronësi paisje për zyre, duhet të ekzistojë edhe zyra, e paguar ose e paraqitur si kontribut me mall dhe shërbime. Poashtu qiraja për zyrë i është shtuar atyre degëve që kanë pasur aktivitete, por që kanë dorëzuar formularë të paplotësuar.

Selia kryesore e AAK-së ka raportuar kontribute me mall ose me shërbime nga 8 të punësuar. Mes tyre është vetëm një truproje. Njësia e Revizionit ka shtuar dy truproje dhe 8 roje të sigurisë, me qëllim të vlerësimit të të dalave, për shkak të mungesës së informacionit të saktë nga partia.

Supozohet se subjektet politike, gjatë fushatës së zgjedhjeve, “punësojnë” njerëz (me pagesë ose pa pagesë). Për secilën degë është punësuar së paku një person. Gjithashtu janë shtuar edhe faturat e telefonit (jo vetëm të zyrës por gjithashtu edhe të telefonave privatë të anëtarëve dhe përkrahësve të përdorur në dobi të subjektit), paisjet dhe materiali për zyre. Përveç asaj që është publikuar nga AAK-ja, Njësia e Revizionit vlerëson se kjo parti ka shpenzuar edhe 49,021 € për fuqinë punëtore, qira për zyre, telefona, pajisje, etj.

AAK-ja nuk është e regjistruar te autoriteti i taksave për të ardhurat personale të të punësuarve. AAK-ja deklaron se nuk i paguan të punësuarit e saj, edhe pse kjo duhet të pasqyrohet në raportin e publikimit si kontribut me mall dhe shërbim për subjektin.

#### PËRFUNDIM

Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, AAK-ja ka raportuar më pak dala për 180,348 €. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës të siguruara nga subjekti, Njësia e Revizionit nuk mund të përcaktojë se a është kjo mospërputhje ende borxh, është paguar apo mund të konsiderohet si kontribut me mall dhe shërbime. Pasi që AAK-ja ka deklaruar borxhet e saj, alternativat me gjasë më të madhe janë: të hyra në të holla apo kontribute me mall dhe shërbime të raportuara më pak. Mospërputhja mes mjeteve dhe borxheve/saldoja në fund të periudhës së raportimit është 179,674 euro. Njësia e Revizionit e konsideron këtë shifër si të hyra të raportuara më pak nga subjekti.

#### 5.4 KP

Personi i financave për kontakte	Mirjana Rajović
Kandidatë të zgjedhur	24
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	27/23

#### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

KP-ja ka dorëzuar formularët e publikimit të financave për shtatë nga 23 degët e tyre komunale. Gjithashtu nuk është dorëzuar Formulari 308 për Selinë e tij kryesore. Shërbimi i Partive Politike ka paraqitur një ankesë në NKZPA kundër KP-së për dorëzim me vonesë dhe jokomplet. Si përgjigje në kërkesën e NKZPA-së për informata shtesë, KP-ja ka dorëzuar formularët dhe dokumentacionin për 16 degët e tjera, por jo edhe për Selinë e tij kryesore. Është mbajtur një takim me personin e financave për kontakte, të cilin ky subjekt i ka dorëzuar shifrat e reja, duke e përfshirë edhe Selinë e tij kryesore. KP-ja nuk ka ofruar dokumentacion mbështetës tjetër përveç kostos së broshurave të shtypura në Shtërpcë.

#### MJETET

KP-ja nuk ka publikuar kurrfarë mjetesh. Kjo iniciativë qytetare deklaron se ka përdorur paisje (p.sh: telefona, kompjutera, vetura, dhe hapësira për zyre) të anëtarëve të KP-së, të donatorëve dhe kontribuesve. Përndryshe Njësia e Revizionit nuk ka informata.

Njësia e Revizionit dëshiron të theksojë se llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) ose të hyrat do të duhet të rriten në masë të konsiderueshme, në mënyrë që të balancohen llogaritë e KP-së. Prandaj, borxhet e publikuara nga KP-ja janë të pasakta.

#### BORXHET

KP-ja nuk ka raportuar borxhe për periudhën e fushatës.

#### TË HYRAT

KP-ja ka publikuar 890 € donacione në të holla dhe 16,023 € kontribute me mall ose me shërbime. Sidoqoftë, KP-ja nuk ka dhënë identitetin e shumicës së kontribuesve të tij me mall ose me shërbime. Sipas personit të financave për kontakte, arsyeja për këtë mospërputhje është se këta persona nuk kanë dashur që t'u përmenden emrat e tyre. Në vend të përmendjes së emrave të kontribuesve me mall ose shërbime, personi i financave për kontakte i KP-së ka paraqitur në formularët e publikimit të financave 'punë e kryer vullnetare' apo 'shërbime vullnetare të pranuar'. Kjo sjellje është qartazi në mospërputhje me Rregullën e Zgjedhjeve 5/2002, neni 3.

#### SHPENZIMET



Sipas vlerësimeve të revizorit, të dalat e KP-së kanë qenë më të mëdha se ato që janë raportuar. Pas takimit të lartpërmendur, të mbajtur më 20.11.2002, janë dorëzuar shifra të reja, mes tyre edhe për shpenzimet. Në versionin e ripërtirë të dorëzuar, KP-ja ka deklaruar se ka shpenzuar 16,913 €.

a. Realizimi i TV/radio spoteve

Njësia e Revizionit nuk ka marrë asnjë informatë në lidhje me TV spotet, radio spotet dhe reklamimet e mundshme në gazeta gjatë periudhës së fushatës. Poashtu revizorët kanë udhëtuar edhe në Serbi dhe Mal të Zi për të monitoruar çfarëdo aktiviteti të subjekteve politike serbe në lidhje me fushatën. Nuk janë vërejtur as posterë, as pllakate, e as ndonjë ngjarje në lidhje me fushatën e organizuar nga KP-ja.

b. Materiali tjetër i shtypur

KP-ja ka raportuar 120 € për shtypjen e broshurave në Shtërpcë dhe 20 € për fuqinë punëtore të përdorur për shpërndarjen e këtyre materialeve. Revizori i konsideron këto shifra si të pranueshme.

c. Tubimet

KP-ja nuk ka deklaruar shpenzime për tubime. Kjo është në pajtim me informatën e marrë nga Policia e UNMIK-ut për aktivitetin politik gjatë fushatës zgjedhore.

d. Vëzhguesit e paguar politikë

KP-ja nuk ka paraqitur shpenzime për vëzhguesit e tyre gjatë Ditës së Zgjedhjeve. Sidoqoftë, KP-ja ka akredituar 38 vëzhgues dhe kostoja e tyre nuk është deklaruar në formularin e publikimit të financave. Njësia e Revizionit ka caktuar koston mesatare të tyre në vlerën 20 € Gjatë takimit me personin e financave për kontakte të KP-së, ajo ka pranuar se kanë shpenzuar 600 € për vëzhgues.

e. Shpenzimet e përgjithshme

Edhe pse KP-ja në fillim nuk ka raportuar kurrëfarë shpenzimesh të përgjithshme, në dorëzimin e dytë të shifrave subjekti ka bërë të ditur se ka shpenzuar 11,020 €

## KONKLUKDIM

Në bazë të raportit fillestar të dorëzuar nga KP-ja, Njësia e Revizionit ka konsideruar se shpenzimet e fushatës kanë qenë të raportuara më pak, dhe ka caktuar shpenzimet reale në vlerë prej 18,494 € KP-ja ka ridorëzuar formularët e saj të publikimit të financave për të gjitha degët komunale dhe ka deklaruar koston e përgjithshme prej 16,913 €

Dorëzimi përfundimtar i publikimit të financave të KP-së tregon se nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme mes raportit përfundimtar të KP-së dhe konstatimeve të Njesisë së Revizionit. Në anën tjetër, KP-ja nuk ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpenzimet e veta, pasi që të gjitha ato kanë qenë të financuara nga anëtarët apo donatorët në formë të donacioneve në të holla dhe kontributeve me mall ose me shërbime. Poashtu KP-ja nuk ka dorëzuar shifrat për Selinë e saj, e cila ndodhet në Beograd.

## 5.5 DSS

Personi i financave për kontakte	Nebojsa Minić
Kandidatë të zgjedhur	27
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	14/13

### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

Për periudhën e dytë dhe përfundimtare të publikimit të financave, DSS-ja ka dorëzuar Formularin 308 për 13 komuna në të cilat ka marrë pjesë në zgjedhje. Sidoqoftë, partia nuk ka dorëzuar dokumentacion mbështetës dhe kopjen e librave të saj të kontabilitetit. Për këtë arsye, është parashtruar një ankesë kundër DSS-së në NKZPA.

### MJETET

DSS-ja ka publikuar mjete në vlerë të përgjithshme prej 8,818 €

### BORXHET

Në përfundim të periudhës së fushatës, DSS-ja ka raportuar një fitim prej 5,840 € Pavarësisht nga ky publikim, konstatimet e Njesisë së Revizionit tregojnë se në vend të kësaj partia ka borxh 360 €

### TË HYRAT

DSS-ja nuk ka deklaruar të hyra në raportin e saj.

### SHPENZIMET

Në bazë të informatave të dorëzuara (asnjë), DSS-ja ka deklaruar se nuk ka shpenzuar kurrëfarë të hollash gjatë fushatës zgjedhore.

Njësia e Revizionit e konsideron këtë rrethanë si kundërthënëse; në bazë të konstatimeve të saj, të dalat e përgjithshme të DSS-së do të duhej të ishin 13,200 €, nga të cilat vetëm shpenzime për zyre do të ishin 7,800 €

### KONKLUDIM

Për shkak të dorëzimit jo të plotë të raportit të saj, Njësia e Revizionit konsideron se DSS-ja nuk ka raportuar të dala në vlerë prej 13,200 €

## 5.6 KDTP

Personi i financave për kontakte	Ercan Špat
Kandidatë të zgjedhur	5
Numri i komunave në të cilat është aplikuar për vërtetim / të vërtetuara	5/4

### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

Në periudhën e dytë dhe përfundimtare të publikimit, KDTP-ja ka dorëzuar në afatin e caktuar Formularin 308 për Selinë e saj kryesore dhe katër degët e saj, duke përfshirë dokumentacionin mbështetës për të gjitha të dalat e saj.

**MJETET**

KDTP-ja në raportin e saj ka publikuar se ka në pronësi pajisje për zyre në vlerë prej 5,150 €

**BORXHET**

Në përfundim të fushatës zgjedhore, KDTP-ja nuk ka deklaruar asnjë borxh. Njësia e Revizionit dëshiron të theksojë se llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) apo të hyrat do të duhej të ngriten dukshëm në mënyrë që të balancohen llogaritë e KDTP-së. Prandaj, borxhet e publikuara nga KDTP-ja janë të pasakta. Njësia e Revizionit mendon se KDTP-ja i ka raportuar borxhet e saja më pak.

**TË HYRAT**

Të hyrat e përgjithshme të raportuara nga KDTP-ja për periudhën e fushatës kanë qenë 7,890 € nga të cilat 6,020 € kanë ardhur nga donacionet në të holla, 670 € nga kontributet me mall ose me shërbime dhe 1,200 € nga tarifat e anëtarësisë. Njësia e Revizionit dëshiron të theksojë se llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) apo të hyrat do të duhej të ngritën dukshëm në mënyrë që të balancohen llogaritë e KDTP-së. Prandaj, të hyrat e publikuara nga KDTP-ja konsiderohen të pasakta. Edhe pse shifrat e publikuara si donacione apo kontribute me mall ose me shërbime duken të besueshme, sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, KDTP-ja i ka raportuar më pak të hyrat e saj.

**SHPENZIMET**

KDTP-ja ka paraqitur si shpenzime gjithsejt 12,740 € gjatë periudhës së fushatës. Njësia e Revizionit ka vlerësuar shpenzimet e tyre në vlerë prej 13,173 €

**KONKLUDIM**

Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, KDTP-ja ka raportuar më pak shpenzime të fushatës së saj në vlerë prej 702 €

**5.7 VATAN**

Personi i financave për kontakte	Fahrudin Medjedović
Kandidatë të zgjedhur	7
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	8/8

**FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI NDIHMËS TË DORËZUAR**

Për periudhën e dytë dhe të fundit të publikimit të financave, VATAN-i ka dorëzuar brenda afatit Formularin 308 për Selinë qendrore dhe për tetë degë. Njësia e Revizionit e ka pranuar dokumentacion mbështetës për deklaratat e këtij subjekti dhe kopjen e librave të kontabilitetit.

**MJETET**

Në fund të periudhës së fushatës së zgjedhjeve, VATAN-i pohon se posedon mjete në vlerë prej 1,250 €, përveç parave të gatshme. Njësia e Revizionit i ka pranuar të gjitha shifrat që janë cekur si mjete nga VATAN-i.

#### BORXHET

Që nga përfundimi i periudhës së fushatës, VATAN-i ka paraqitur borxhe në shumën prej 840 €. Njësia e Revizionit konstaton me bindje të plotë se shuma e cekur e borxheve është e pasaktë. Siç është thënë në këtë raport, detyrimet financiare (borxhet) që mund të paguhen ose të hyrat duhet të shtohen dukshëm për t'i balancuar borxhet e VATAN-it.

#### TË HYRAT

VATAN-i ka publikuar 265 € si të hyra të përgjithshme për periudhën e raportimit. Të hyrat ose detyrimet financiare (borxhet) që mund të paguhen duhet të shtohen dukshëm për të kthyer bilancin në borxhet e VATAN-it. Prandaj, Njësia e Revizionit konstaton me bindje të plotë se shuma e cekur është e pasaktë.

#### SHPENZIMET

##### a. Pllakatet dhe materialet e tjera të shtypura

VATAN-i pohon se ka shpenzuar 175 € për materialet e tjera të shtypura. Njësia e Revizionit nuk e konsideron të besueshme shifrën e cekur nga VATAN-i, duke marrë parasysh se ky koalicion ka konkuruar për zgjedhje në 8 komuna. Njësia e Revizionit ka vlerësuar se shifra e arsyeshme duhet të jetë së paku 1,000 €.

##### b. Gjërat e shpërndara falas

VATAN-i pohon se ka shpenzuar 495 € për shpërndarje të gjësendeve falas. Njësia e Revizionit i konsideron dalat e tilla të pranueshme.

##### c. Realizimi i spoteve në TV dhe radio

VATAN-i pohon se ka shpenzuar 20 € për realizimin e spoteve në TV dhe radio. Sipas shënimeve të Njesisë së Revizionit, VATAN-i ka emetuar vetëm një spot televiziv. Shpenzimet për atë spot llogariten se jenë 500 deri 1000 €. Për këtë arsye, shifrës së cekur nga koalicioni i janë shtuar 750 €.

##### d. Tubimet

VATAN-i paraqet të dala prej 650 € për tubime.

Sipas shënimeve të marra nga POLICIA E UNMIK-ut, VATAN-i i ka mbajtur 11 tubime gjatë periudhës së zgjedhjeve. Tubimet janë mbajtur në lokacione të ndryshme, si në salla sportive, qendra kulturore, teatra dhe në vende të hapura. Për organizimin e tubimeve në këto vende nevojiten pajisje të veçanta, si sistemi i zërimit (përfshirë mikrofonat, zmadhuesit e zërit, kabllo dhe mikserët e zërit) dhe sigurimi. Përveç kësaj, është dashur të paguhet qira, po edhe nëse nuk është paguar qira, ajo është dashur të vlerësohet si kontribut me mall.

Njësia e Revizionit ka marrë sugjerime nga vëzhguesit e tubimeve, të cilat kanë qenë të dobishme për llogaritjen e shpenzimeve të përafërta për çdo tubim. VATAN-i e ka dorëzuar dokumentacion mbështetës për disa tubime, por jo për të gjitha.

Duke u bazuar në informatat e marra nga ky subjekt, në raportet e organizatave vëzhguese dhe në çmimet e tregut, Njësia e Revizionit ka vlerësuar se VATAN-i i ka shpenzuar 2,640 € për tubime.

#### e. Transporti

VATAN-i i ka publikuar 100 € si shpenzime të përgjithshme për transport gjatë periudhës së fushatës. Duke pasur parasysh se VATAN-i ka konkuruar në 8 komuna të ndryshme dhe ka raportuar se posedon vetëm një automjet (dega në Pejë), 100 € si shpenzime të përgjithshme për transport nuk duket të jetë shifër e saktë. Njësia e Revizionit ka shtuar një shumë minimale të shpenzimeve për lëndë djegëse, marrje të veturave me qira dhe për shoferë për çdo degë tjetër të këtij subjekti. Shifra që është shtuar është 3,770 €.

#### f. Repezantacioni

VATAN-i pohon se ka shpenzuar 17 € për pritje, tubime politike dhe dreka. Njësia e Revizionit mendon se shifra e cekur nuk është e arsyeshme. Prandaj, revizorët kanë shtuar shumën prej 150 eurove për çdo degë tjetër të këtij subjekti, disa prej të cilave kanë dorëzuar raporte me formularë të zbrazët (pa shpenzime).

#### g. Shpenzimet e përgjithshme

VATAN-i ka paraqitur 35 € si shpenzime të përgjithshme gjatë fushatës së periudhës. Ky koalicion pohon se posedon pajisje për zyrë në katër degë të tij. Zakonisht, pajisjet për zyrë qëndrojnë në zyra, ndërsa ato zyra kanë çmim, i cili ose paguhet, ose konsiderohet si kontribut me mall. Ne besojmë se anëtarët e Koalicionit kanë kryer disa punë në të mirë të këtij subjekti gjatë periudhës së fushatës dhe kemi një lloj komunikimi me ta. Për këtë arsye, Njësia e Revizionit ka shtuar shpenzimet e llogaritura për marrjen e zyrave me qira, për rroga dhe fatura të telefonit për të gjitha degët e këtij subjekti. Vlerësohet se VATAN-i, gjatë periudhës së fushatës, ka shpenzuar gjithsej 9,750 €, qoftë në të holla, ose në mall.

### PËRFUNDIM

Njësia e Revizionit mendon se VATAN-i në raportin e vet i ka zvogëluar shpenzimet e tij për 18,083 €. Si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit mbështetës që është dashur ta sigurojë ky subjekt del se Njësia e Revizionit nuk mund të përcaktojë nëse kjo mospërputhje nënkupton borxh të mbetur, të paguar apo si vlerë që mund të konsiderohet si kontribut me mall. Meqë VATAN-i i ka cekur borxhet e veta, alternativat më të mundshme mund të jenë të hyra të zvogëluara me para ose me kontribute me mall. Vlera e mospërputhjes ndërmjet mjeteve dhe borxheve/saldos në fund të periudhës së raportimit është 18,083 €. Njësia e Revizionit konsideron se kjo shifër nënkupton paraqitje më të ulëta të të hyrave nga ana e këtij subjekti.

### 5.8 PReK

Personi i financave për kontakte	Skender Kada
Kandidatë të zgjedhur	3
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	9/7

## FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS TË DORËZUAR

PReK-u e ka dorëzuar brenda afatit Formularin 308 për Selinë qendrore dhe për 7 degë komunale. Njësia e Revizionit nuk ka marrë dokumentacion mbështetës për deklaratat ose kopjen e librave të kontabilitetit nga ky subjekt. Lidhur me këtë i është parashtruar ankesë NKZPA-së.

### MJETET

Në raportin e tij të fundit të publikimit të financave, PReK-u pohon se posedon pajisje për zyrë në vlerë prej 10,863 €, të gjitha këto të vendosura në Selinë qendrore. Njësia e Revizionit ka pranuar të gjitha shifrat e cekura si mjete nga PReK-u.

### BORXHET

Që nga fundi i periudhës së fushatës, PReK-u nuk paraqet asnjë borxh. Njësia e Revizionit konstaton me bindje të plotë se shuma e cekur e borxheve është e pasaktë. Siç është cekur më poshtë në këtë kaptinë, detyrimet financiare (borxhet) që mund të paguhen ose të hyrat duhet të shtohen dukshëm për t'i balancuar borxhet e PReK-ut.

### TË HYRAT

PReK-u ka paraqitur 54,500 € si shumë të përgjithshme të të hyrave për periudhën e fushatës. Sipas PReK-ut, të gjitha këto të hyra vijnë nga donacionet në të holla. Edhe pse burimet e donacioneve të cekura në të holla janë publikuar, të hyrat ose detyrimet financiare (borxhet) që mund të paguhen duhet të shtohen dukshëm për ta rikthyer balancin e borxheve të PReK-ut. Prandaj, Njësia e Revizionit konstaton me bindje të plotë se shuma e cekur e të hyrave është e pasaktë dhe e zvogëluar.

### SHPENZIMET

a. Pllakatet, materialet e tjera të shtypura dhe gjësendet e shpërndara falas.  
PReK-u pohon se ka shpenzuar 21,811 € për këta tre artikuj, shifër kjo që është pranuar nga Njësia e Revizionit.

b. Realizimi i spoteve në TV dhe radio

PReK-u pohon se ka shpenzuar 13,050 € për spote në TV dhe radio. Njësia e Revizionit e konsideron shifrën e dhënë të arsyeshme.

c. Reklamat në gazeta

PReK-u paraqet të dala në shumë prej 3,956 € për reklama në gazeta. Njësia e Revizionit epranon shifrat e dhëna si të arsyeshme.

d. Tubimet

PReK-u ka paraqitur 515 € të dala për tubime të mbajtura në tërë Kosovën.

Njësia e Revizionit do të preferonte t'i bëjë vlerësimet e saj duke u bazuar në dokumentacionin mbështetës të dorëzuar nga vetë subjekti, por si shumë subjekte të tjera politike, edhe PReK-u nuk ka dorëzuar asnjë informacion të tillë.

Sipas shënimeve të marra nga POLICIA E UNMIK-ut, PReK-u ka mbajtur 8 tubime gjatë periudhës së fushatës. Tubimet janë mbajtur në lokacione të ndryshme si në salla të sportit, kinema, shtëpi të kulturës, zyra të partisë, shtëpi private dhe në vende të hapura. Për tubime që nuk mbahen nëpër shtëpi private, por në vende të tjera nevojiten pajisje të veçanta si skena, sistemi i zërimit (përfshirë mikrofonët, zmadhuesit e zërit, kabllot dhe mikserët e zërit) dhe sigurimi. Përveç kësaj, shpenzimet e qirasë, qoftë të paguara, qoftë të papaguara, duhet të konsiderohen kontribut me mall.

Duke u bazuar në informatat që i kemi marrë nga vëzhguesit dhe në çmimet e tregut, revizorët mendojnë se PReK-u ka shpenzuar gjithsej 10,944 € për tubime.

#### e. Transporti

PReK ka paraqitur 1,478 € si shumë të shpenzimeve për transportim gjatë periudhës së zgjedhjeve. Meqë PReK-u nuk posedon asnjë automjet, të gjitha automjetet e përdorura është dashur t'i marrë me qira, ose t'i sigurojë nga anëtarët apo përkrahësit e këtij subjekti. Mënyra e sigurimit të automjeteve është e parëndësishme për llogaritjen e shpenzimeve. Për këtë arsye, Njësia e Revizionit ka caktuar një çmim konvencional për marrjen me qira të automjeteve të vogla.

Duke marrë parasysh aktivitetet e ndërmarra nga PReK-u gjatë periudhës së zgjedhjeve, Njësia e Revizionit e konsideron si të dyshimtë faktin që PReK-u nuk ka paraqitur asnjë shpenzim transportimi për Selinë e vet qendrore. Revizorët gjithashtu kanë përfshirë shpenzimet për lëndë djegëse, automjete dhe shoferë. PReK-u pohon se për shumicën e degëve ka shpenzuar para vetëm për lëndë djegëse. Për ta shfrytëzuar si duhet këtë lëndë djegëse kërkohet që të posedohen, ose së paku të shfrytëzohen, automjete dhe të punësohen shoferë. Për këtë shkak, Njësia e Revizionit ka shtuar të dalat për përdorimin e veturave dhe angazhimin e shoferëve.

Njësia e Revizionit beson se PReK-u i ka shpenzuar 16,493 € për transportim gjatë periudhës së fushatës.

#### f. Reprerentacioni

PReK-u pohon se ka shpenzuar 3,237 € për pritje, tubime politike dhe dreka. Njësia e Revizionit konstaton se shifrat e dhëna nga PReK-u janë të pranueshme.

#### g. Marrja me qira e sallave të mbledhjeve

PReK-u pohon se ka shpenzuar 50 € për marrjen me qira të sallave të mbledhjeve në gjithë Kosovën gjatë periudhës 45-ditëshe të fushatës. Sipas raporteve të mbikëqyrjes së mediave, PReK-u ka mbajtur 4 mbledhje dhe konferenca të ndryshme për shtyp gjatë periudhës së zgjedhjeve. Si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit mbështetës, ne i kemi shënuar 200 € për çdo mbledhje, pra një shumë të përgjithshme prej 800 €.

#### h. Vëzhguesit politikë të paguar

PReK-u pohon se PëR vëzhguesit politikë ka paguar 3,051 €. Njësia e Revizionit konsideron se kjo shifër është përafërsisht e saktë.

#### i. Shpenzimet e tjera në lidhje me aktivitetin e fushatës

PReK-u pohon se ka shpenzuar 593 € për këtë qëllim, ndërsa Njësia e Revizionit e pranon këtë shifër.

#### j. Shpenzimet e përgjithshme

PReK-u ka raportuar të dala prej 6,044 € për shpenzimet e përgjithshme gjatë periudhës së fushatës. Kjo parti pohon se paguan qira për godinën e Selisë së saj qendrore dhe për shumicën e degëve të saj. Sipas raportit të kësaj partie, del se kurrfarë pune nuk është duke u bërë në këto zyra ndonëse janë paguar faturat e telefonit. Për këtë arsye, Njësia e Revizionit ka shtuar të dala të llogaritura për nëpunësit e Selisë qendrore, si dhe për ata të degëve. Janë shqyrtuar dhe parashtruar edhe shpenzimet e faturave të telefonit dhe të shërbimeve të tjera.

#### PËRFUNDIM

Njësia e Revizionit mendon se PreK-U në raportin e tij i ka zvogëluar shpenzimet e tij për afër 40,000 €. Si rrjedhojë e mungesës së dokumentacionit mbështetës që është dashur ta dorëzojë ky subjekt, del se Njësia e Revizionit nuk mund të përcaktojë nëse kjo mospërputhje nënkupton borxh të papaguar, të paguar apo diçka që duhet të konsiderohet si kontribut me mall. Meqë PReK-u i ka cekur borxhet e veta, alternativa më e mundshme është se të hyrat e zvogëluara janë para ose kontribute me mall. Vlera e mospërputhjes ndërmjet mjeteve dhe borxheve dhe saldosh në fund të periudhës së raportimit është 40,229 €. Kjo shifër, sipas Njesisë së Revizionit, nënkupton paraqitje të zvogëluar të të hyrave nga ana e këtij subjekti.

#### 5.9 IRDK

Personi i financave për kontakte	Kapllan Kersh
Kandidatë të zgjedhur	4
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	8/7

#### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS TË DORËZUAR

Për periudhën e dytë dhe të fundit të publikimit të financave, IRDK-ja e ka dorëzuar Formularin 308 për shtatë komunat në të cilat ka konkuruar për zgjedhje. Megjithatë, kjo parti nuk e ka dorëzuar dokumentacionin mbështetës dhe kopjen e librave të kontabilitetit. Për këtë arsye, ndaj IRDK-së është parashtruar ankesë në NKZPA.

#### MJETET

IRDK-ja nuk ka publikuar kurrfarë mjeteve në raportin e saj.

#### BORXHET

Sipas raportit të saj, partia ka llogaritur 3,450 € borxhe. Sipas llogaritjeve të veta, Njësia e Revizionit vlerëson se borxhet e kësaj partie arrijnë shumën prej 6,653 €.

#### TË HYRAT

IRDK-ja ka paraqitur 3,650 € si shumë të përgjithshme të të hyrave, nga të cilat 3,330 € vijnë nga donacionet me mbi 100 € dhe 350 nga donacionet me nën 100 € gjatë periudhës së fushatës.

#### SHPENZIMET



IRDK-ja ka parqitur të dala të përgjithshme prej 3,550 €. Megjithatë, sipas konstatimeve të Njesisë së Revizionit, këto shpenzime duhet të jenë 11,828 €. Arsyet kryesore për këtë mospërputhje mund të jenë realizimi i spoteve në TV ose radio (mospërputhja në vlerë prej 2,850 €) dhe shpenzimet për zyrë dhe fuqi punëtore (mospërputhja në vlerë prej 3,600 €).

## PËRFUNDIM

Njësia e Revizionit konsideron se IRDK-ja në raportin e saj ka paraqitur shpenzime më të ulëta për gjithsej 8,278 € të shpenzuara gjatë periudhës së fushatës.

### 5.10 SNV-ja

Personi i financave për kontakte	Miodrag Raliq
Kandidatë të zgjedhur	24
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	3/3

## FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

Për periudhën e dytë dhe të fundit të publikimit të financave, SNV-ja ka dorëzuar Formularin 308 për Selinë e saj kryesore dhe për 3 degët komunale në të cilat ajo ka marrë pjesë në zgjedhje.

## MJETET

SNV-ja ka raportuar mjete në vlerë prej 1,460 €, kryesisht pajisje të zyrës. Njësia e Revizionit konsideron se vlera e mjeteve të raportuara është e pranueshme.

## BORXHET

Asnjë borxh nuk është raportuar për periudhën e fushatës. Njësia e Revizionit dëshiron të theksojë se llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) apo të hyrat duhet të ngriten dukshëm për t'i balancuar llogaritë e SNV-së. Prandaj, borxhet të publikuara nga SNV-ja janë të pasakta.

## TË HYRAT

SNV-ja ka publikuar 7,500 € si të hyra gjatë periudhës së fushatës. Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit shifra e paraqitur duhet të merret si e pasaktë. Njësia e Revizionit dëshiron të theksojë se llogaritë që duhet të paguhen (borxhet) apo të hyrat duhet të ngriten dukshëm për t'i balancuar llogaritë e SNV-së. Prandaj, të hyrat e publikuara nga SNV-ja konsiderohen si të pasakta.

## SHPENZIMET

SNV-ja ka raportuar të ketë shpenzuar gjithsej 2,722 € për fushatën e zgjedhjeve. Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit shifrat e paraqitura duhet të konsiderohen të pasakta. Sipas vlerësimeve të bëra nga revizorët, shpenzimet totale të SNV-së do të duhej të ishin 6,544 €.

## KONKLUZIM

Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, SNV-ja i ka raportuar më pak shpenzimet e fushatës për 3,821 €.

## 5.11 LKÇK-ja

Personi i financave për kontakte	Fadil Fazliu
Kandidatë të zgjedhur	0
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	20 /18

### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

Për periudhën e dytë dhe të fundit të publikimit të financave, LKÇK-ja ka dorëzuar Formularin 308 për Selinë e vet kryesore dhe për 17 degët brenda afatit. Për 10 degë të veta, LKÇK-ja ka dorëzuar formularë të paplotësuar. Për 7 degët e mbetura deklarohet se kanë vetëm pajisje në zyrë, kurrëfarë të hyre dhe kurrëfarë të dale. Njësia e Revizionit e ka marrë dokumentacionin mbështetës për të hyrat dhe të dalat e paraqitura për Selinë kryesore.

#### MJETET

LKÇK –ja raporton se ka në pronësi pajisje për zyrë në vlerë prej 5,020 € për Selinë kryesore dhe për 7 degë. Njësia e Revizionit ka pranuar të gjitha shifrat e paraqitura si mjete nga LKÇK-ja .

#### BORXHET

Që nga fundi i periudhës së fushatës, LKÇK-ja nuk ka deklaruar kurrëfarë borxhi. Njësia e Revizionit konstaton me bindje të plotë se shuma e paraqitur e borxheve është e pasaktë. Llogaritë që duhet të paguhet (borxhet) apo të hyrat duhet të shtohen dukshëm për t'i balancuar llogaritë e LKÇK-së.

#### TË HYRAT

LKÇK-ja ka raportuar të hyra totale prej 13,132 €, të hyrat që rrjedhin nga donatorët monetarë dhe kontributet në mallra dhe shëbime. Identiteti i donatorëve është shpallur sipas Rregullës së Zgjedhjeve 5/2002. Njësia e Revizionit konstatin me bindje të plotë se shuma e paraqitur e të hyrave është e pasaktë dhe nuk është e mjaftueshme për t'i mbuluar të dalat e llogaritura të LKÇK-së.

#### SHPENZIMET

a. Materiale të tjera të shtypura dhe artikujt që shpërndahen falas.

LKÇK–ja deklaron se ka shpenzuar 1,702 € në materiale të tilla. Njësia e Revizionit i konsideron shifrat e paraqitura nga LKÇK-ja si të pranueshme.

b. Tubimet

LKÇK–ja zbulon të dalat prej 1,725 € të shpenzuara në tubime.

Sipas dosjeve nga POLICIA E UNMIK-ut, LKÇK-ja ka mbajtur 9 tubime gjatë periudhës së fushatës. Tubimet janë mbajtur në lokacione të ndryshme, si në sallat sportive, kinema, qendra kulturore dhe hotele. Tubimet e organizuara në vende të tilla kërkojnë pajisje speciale, si skena, sistem zërimi (përfshirë mikrofonat, autoparlantët, kabllot dhe mikserët e zërit) dhe rojet e sigurimit. Përveç kësaj, qiraja për këto vende është dashur të paguhet , e nëse jo, është dashur të konsiderohet si kontribut me mall ose me shërbime.

Njësia e Revizionit ka marrë reagime nga organizatat e vërtetuara të vëzhguesve lidhur me disa tubime të LKÇK-së, të cilat kanë ofruar informata të dobishme për llogaritjen e shpenzimeve të përafërta për secilin tubim. Njësia e Revizionit do të preferonte ta bëjë llogaritjen duke u bazuar në dokumentet mbështetëse që është dashur t'i dorëzojë vetë subjekti, por, si shumë subjekte të tjera politike, LKÇK-ja nuk ka dorëzuar informata të tilla, ose nëse i ka dorëzuar, këto informata kanë qenë shumë të kufizuara.

Në bazë të informatave që i kemi marrë nga vëzhguesit dhe çmimet e tregut, Njësia e Revizionit konsideron se LKÇK-ja ka shpenzuar 2,675 € për tubime.

#### c. Transporti

LKÇK-ja ka deklaruar 4,800 € (nga të cilat 300 € janë bartur te shpenzimet e përgjithshme si shpenzime për karburant për gjenerator) si shpenzime transporti nga të cilat vetëm shpenzime për karburant gjatë periudhës së fushatës janë publikuar.

LKÇK-ja nuk ka deklaruar se ka në pronësi ndonjë automjet. Prandaj, karburanti që është blerë është dashur të përdoret për automjetet e marra me qira apo të siguruar nga anëtarët/përkrahësit. Poashtu për automjetet nevojiten shoferat. Për qëllim të revizionit është e parëndësishme se si janë siguruar automjetet. Njësia e Revizionit ka aplikuar, siç është bërë edhe me subjektet të tjera, një çmimi konvencional për marrjen me qira të automjeteve të lehta.

Duke marrë parasysh aktivitetet e ndërmarra nga LKÇK-ja gjatë periudhës së fushatës, Njësia e Revizionit nuk i duket i besueshëm fakti që LKÇK-ja nuk ka paraqitur ndonjë shpenzim të transportit për 18 degët e veta. Njësia e Revizionit ka shtuar shpenzimet për karburant, automjete dhe shofera për degët dhe për Selinë kryesore. Shuma e shtuar nga Njësia e Revizionit në vend të informatave të siguruar nga subjekti, është 18,990 €.

#### d. Shpenzimet e reprezentacionit

LKÇK-ja ka publikuar 1,330 € shpenzime për pritje, ngjarje dhe darka për selitë kryesore. Njësia e Revizionit ka pranuar shifrën e paraqitur nga LKÇK-ja për Selinë kryesore, por ka shtuar 1,800 € për 18 degët e saj, meqë kurrëfarë shpenzimesh nga reprezentacioni nuk janë publikuar për zyrat e degëve komunale.

#### e. Marrja me qira e sallave të mbledhjeve

LKÇK-ja nuk ka paraqitur kurrëfarë shpenzimi për marrjen me qira të sallave për mbledhje. Sipas raporteve nga Monitorimi i Mediave i OMIK-ut, LKÇK-ja ka mbajtur dy mbledhje gjatë periudhës së fushatës. Këto mbledhje përbëjnë një element shpenzimi, pa marrë parasysh se a definohet si shpenzim në të holla apo si kontribut me mall dhe shërbime. Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës, Njësia e Revizionit ka shtuar 200 € për çdo mbledhje që paraqet shumën prej gjithsej 400 €.

#### f. Vëzhguesit e paguar politikë

LKÇK-ja deklaroi se nuk i ka paguar vëzhguesit e vet politikë. Njësia e Revizionit vlerëson se puna e kryer nga vëzhguesit politikë duhet të konsiderohet si përfitim për partinë, pa marrë parasysh se a është paguar apo jo. Mesatarisht, është vlerësuar se një vëzhgues politik ia ka kushtuar dy ditë të zakonshme të punës (nga 8 orë) subjektit. Vlera e kësaj pune është caktuar 20 €. LKÇK-ja ka akredituar 32 vëzhgues. Prandaj vlera është llogaritur të jetë 640 €.

#### g. Shpenzimet e përgjithshme

LKÇK-ja nuk ka deklaruar kurrfarë shpenzimi të përgjithshëm, përveç 4,800 € të bartura nga shpenzimet e transportit (si lëndë djegëse për gjenerator).

LKÇK-ja nuk ka raportuar ndonjë pronësi, pagesë të qirasë apo përdorim pa pagesë për Selinë e saj kryesore në Prishtinë.

Duke marrë parasysh madhësinë e një hapësire të tillë (rreth. 400 m<sup>2</sup>), lokacionin në qendër të Prishtinës dhe intervalin kohor (periudha e fushatës së zgjedhjeve), Njësia e Revizionit ka llogaritur se qiraj është dashur të jetë 1,200 € për afro 400 m<sup>2</sup>. Siç u tha më parë, LKÇK-ja ka deklaruar se ka në pronësi pajisje për zyrë për shatë degë. Mendohet se pajisjet do të qëndrojnë, të përdorura apo jo, në një zyrë për secilën nga shtatë degët. Nëpunësit po ashtu u janë shtuar degëve nga Njësia e Revizionit si dhe shpenzimet e telefonit dhe shërbimet komunale, në mungesë të dokumentacionit mbështetës nga LKÇK-ja.

Në përgjithësi, Njësia e Revizionit ka vlerësuar se shuma e shpenzimeve të përgjithshme të LKÇK-së është 16,600 €.

#### KONKLUDIM

Sipas mendimit të Njesisë së Revizionit, në raportin e saj LKÇK-ja i ka raportuar më pak shpenzimet e saj të fushatës për 40,580 €.

Nga informatat e dorëzuara nuk është e mundur të përcaktohet nëse mospërputhja prej 40,580 € në mes të shifrës së llogaritur nga Njësia e Revizionit dhe shifrës së paraqitur nga LKÇK-ja, është ende e papaguar, e paguar apo që duhet të konsiderohet kontribut me mall ose me shërbime. Alternativa më e mundshme është që të konsiderohet si e hyrë raportuar më pak nga donacionet në të holla apo si kontribut me mall dhe shërbime. Të hyrat në raport janë raportuar më pak për 45,000 €.

#### 5.12 Riza Lluka (Kandidat i pavarur)

Personi i financave për kontakte	Nazmi Gegiqi
Kandidatë të zgjedhur	1
Vërtetimi për paraqitje në komuna/të vërtetuar	1

#### FORMULARËT DHE DOKUMENTACIONI MBËSHTETËS I DORËZUAR

Për periudhën e dytë dhe përfundimtare të publikimit të financave, Z.Lluka ka dorëuar Formularin 308, por nuk ka përfshirë dokumentacionin mbështetës dhe kopjen e librave të kontabilitetit. Për shkak të këtij mosveprimi në përputhje me rregullën, në NKZPA është parashtruar ankesë kundër këtij kandidat. Si rezultat i parashtrimit të kësaj ankese, Z. Lluka ka dorëzuar faturat dhe fletëpagesat dhe listën e donatorëve dhe kontribuesve të fushatës së tij.

#### MJETET

Z.. ka publikuar mjete në vlerë prej 202,940 €. Sidoqoftë, duhet nënvizuar se 190,000 € nga kjo shume korespondon me pronën që ka ky kandidat.

#### BORXHET

Në raport janë paraqitur 204,345 € si saldo dhe borxhe, shifër kjo e cila është konsideruar e arsyeshme nga revizorët.

#### TË HYRAT

Z. Lluka deklaroi se ka marrë 4,600 € si të hyra nga donacionet. Nga kjo shumë, 3,450 € në donacione janë përshkruar si kontribut me mall ose shërbime.

#### SHPENZIMET

Kandidati i pavarur ka publikuar të dala të përgjithshme prej 6,695 €. Njësia e Revizionit, në bazë të vlerësimeve të veta, caktoi shumën e të dalave të Z. Lluka në 9,145 €. Arsyeja kryesore e kësaj mospërputhjeje është ndryshimi në mes të shumës së raportuar për realizimin e spoteve në TV dhe radio dhe çmimit të tregut për një produkt të tillë.

#### KONKLUDIM

Njësia e Revizionit konsideron se Z. Lluka në raportin e tij i ka raportuar më pak shpenzime të tij të përgjithshme për 2,450 € të shpenzuara gjatë periudhës së fushatës.

### 5.13 Subjektet me kandidat të zgjedhur, por jo të analizuar në detale

#### Emri i subjektit politik/ Akronimi

	Të Hyrat		Shpenzimet	
	Të Deklaruara	Zbulimet	Të deklaruar	Zbulimet
BDIKHB	€ 239	€ 934	€ 1,029	€ 1,529
BK	€ 6,464	€ 16,025	€ 12,321	€ 16,003
BSDAK	€ -	€ 1,500	€ 400	€ 1,500
DPP	€ 2,850	€ 2,850	€ 2,600	€ 3,054
DŽZ	€ -	€ 1,890	€ 950	€ 2,840
GIG	€ 130	€ 1,416	€ 212	€ 1,452
GIK	€ -	€ 495	€ 240	€ 735
GIPP	€ 1,500	€ 1,500	€ 1,300	€ 1,500
GISK	€ -	€ 465	€ -	€ 665
GIZ	€ 1,000	€ 1,000	€ 300	€ 1,050
IQFK	€ 30	€ 1,000	€ 30	€ 1,000
IQV	€ 600	€ 1,990	€ 750	€ 1,990
KOS	€ -	€ 17,295	€ 5,435	€ 14,965
LPK	€ 18,158	€ 63,210	€ 21,871	€ 68,546
LZKUS	€ -	€ -	€ 1,450	€ 2,298
OPSTANAK	€ -	€ 1,028	€ 547	€ 1,028
OSA	€ 600	€ 600	€ 1,370	€ 2,318
OSPS	€ 46,400	€ 49,300	€ 35,600	€ 36,600
PD	€ -	€ 34,743	€ 5,800	€ 31,143
PDAK	€ -	€ -	€ 15,920	€ 20,900
PKM	€ 200	€ 8,020	€ 2,000	€ 9,820
PLK	€ 7,561	€ 30,179	€ 10,879	€ 31,049
PSHDK	€ 3,600	€ 22,547	€ 4,515	€ 23,227
SD	€ 653	€ 5,168	€ 665	€ 6,424
SDP	€ 500	€ 5,660	€ 2,500	€ 7,660
SPO	€ -	€ 3,000	€ -	€ 3,000

**5.14 Subjektet pa kandidat të zgjedhur, dhe jo të analizuar në detale**

Emri i subjektit politik	Të hyrat		Shpenzimet	
	Të deklaruara	Zbulimet	Të deklaruara	Zbulimet
Abdulhadi Cufta	€ -	€ -	€ 1,523	€ 1,523
BKDSH	€ 1,180	€ 1,180	€ 2,653	€ 3,503
BZ	€ -	€ -	€ 370	€ 370
Fadil Salihu	€ -	€ -	€ 330	€ 330
GI Gorazdevac	€ -	€ -	€ -	€ -
HZJ	€ -	€ -	€ -	€ -
IQK	€ -	€ -	€ 48,000	€ 48,000
IQL	€ 2,950	€ 2,950	€ 2,181	€ 2,181
IQRK	€ 3,600	€ 3,600	€ 4,570	€ 4,570
KO	€ 460	€ 1,548	€ 1,550	€ 1,550
Miroslav Radosavljevic	€ -	€ -	€ 220	€ 220
NPP	€ -	€ -	€ 50	€ 50
Obrad Tijanic	€ -	€ -	€ -	€ -
PDASHK	€ 600	€ 8,196	€ 600	€ 8,196
PGJK	€ 450	€ 2,110	€ 1,393	€ 3,963
PNDSH	€ -	€ 4,000	€ -	€ 4,000
PREBK	€ -	€ 1,050	€ 2,760	€ 4,760
PRSH	€ -	€ 1,300	€ 485	€ 1,485
PSDK	€ 11,430	€ 22,425	€ 17,210	€ 18,818
Radovan Costic	€ -	€ -	€ 360	€ 360
Rame Dreshaj	€ 300	€ 300	€ 14,950	€ 14,950
SPAS	€ 400	€ 530	€ 400	€ 400
Stojan Perovic	€ -	€ 1,950	€ 3,530	€ 3,530
UNIKOMB	€ -	€ 9,035	€ 65	€ 9,035
Zoran Cirkovic	€ -	€ -	€ -	€ -
Zoran Spasic	€ -	€ -	€ 400	€ 400

## 6. Shtojca A Shprehjet dhe definicionet

**Mjetet** u referohen të gjitha parave në dorë, të gjitha depozitave të bankave, vlerës së pronës së zotëruar, vlerës së bizneseve të zotëruara, vlerës së veturave të zotëruara dhe çdo gjëje tjetër të zotëruar.

**Borxhet** i referohen çdo shume të parave që subjekti politik është i obliguar t'i paguajë për mallërat e dorëzuara ose për shërbimet e bëra, por që nuk janë paguar akoma.

**Bilanci** i referohet 'publikimit financiar të mjeteve, borxheve dhe shumës së kapitalit' të subjekteve politike, siç është përcaktuar më lartë.

**Të hyrat** i referohen çdo shume të parave të pranuar si tarifa të anëtarësisë ose kuota; kontributeve të individëve, bizneseve ose organizatave të ndryshme nga jashtë; kontributeve të individëve, bizneseve ose organizatave të ndryshme; donacioneve të çdo lloji; vlerës së kontributeve në formë mallrash dhe shërbimesh (të kontributeve me mall) dhe çdo pages, siç është përcaktuar në nenin 1a) të Rregullës së Zgjedhjeve 10/2001, të subektit politik.

**Shpenzimet** i referohen çdo pagese (siç është përcaktuar në nenin 1h) të Rregullës së Zgjedhjeve 5/2002) që ka bërë ndonjë subjekt politik për mallrat ose blerjen e mallrave, të materialeve, punëve, shërbimeve qoftë të prekshme ose të paprekshme, që kanë për qëllim të ndikojnë në zgjedhjet, pavarësisht nëse shkon për mbështetjen e ndonjë kandidati të veçantë ose subjekti politik. Shembujt e shpenzimeve përfshijnë, por nuk kufizohen në: shpenzimet e shpalljeve të mediave të shtypit, paraqitjen e transmetimit të spoteve, të materialeve të fushatës, duke përfshirë pamflete, posterë dhe butonë; paraqitjen e shpalljeve, përfshirë standat e pllakateve dhe prodhimet e tyre. Çdo shpenzim bëhet në datën kur janë siguruar mallrat, materialet, punët, ose shërbimet, cilado që të jetë përpara.

**Kufizimi i shpenzimeve të fushatës** është caktuar në 660,000 €.

**7. Shtojca B Paraqitja e raportit të dytë financiar**

**8. Shtojca C Fletë bilanci dhe llogarija e fitim dhe humbjes**

**9. Shtojca D Regjistri I donacioneve monetare dhe kontributeve në mall dhe shërbime për raportin e 1<sup>rë</sup> dhe të 2<sup>të</sup>**